



ProCredit Bank

Kosovo

RAPORTI VJETOR 2016

Përmbajtja

I. Misioni i bankës ProCredit

II. Etika e biznesit dhe standardet mjedisore

II.1. Transparenca

II.2. Kultura e komunikimit të hapur

II.3. Përgjegjësia dhe toleranca shoqërore

II.4. Standarde të larta profesionale

II.5. Integritet dhe përkushtim personal

III. Informatat themelore të bankës ProCredit

IV. Segmentet kyç të biznesit

IV.1. Klientët e biznesit

IV.2. Klientët privatë

IV.3. Depozitat e klientëve privatë

V. Kanalet elektronike të bankimit

VI. Menaxhimi i rrezikut

VI.1. Menaxhimi i rrezikut kreditor për vitin 2016

VI.2. Menaxhimi i rrezikut të ekspozimit ndaj palëve tjera

VI.3. Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit dhe financimit

VI.4. Menaxhimi i rrezikut të valutës

VI.5. Menaxhimi i rrezikut të normës së interesit

VI.6. Adekuatshmëria e kapitalit

VI.7. Menaxhimi i rrezikut operacional dhe i mashtrimit

VI.8. Parandalimi i shpëlarjes së parasë

VII. Punëtorët dhe zhvillimi i tyre

VII.1. Akademitë dhe qendrat e gjuhëve të grupit ProCredit

VII.2. Trajnimet e specializuara dhe trajnimet tjera

VII.3. “ProCredit Entry Programme”

VII.4. Ndërtimi i marrëdhënieve

VIII. Pasqyrat financiare.

Misioni i Bankës

Banka ProCredit është bankë komerciale, e orientuar drejt zhvillimit. Ne ofrojmë shërbime cilësore për bizneset e vogla dhe të mesme, si dhe për klientët privatë që dëshirojnë të kursejnë. Në operacionet tona ne i përmbahemi një numri të caktuar parimesh bazë: ne vlerësojmë transparencën gjatë komunikimit me klientët tanë, nuk promovojmë kredi konsumuese, jemi të përkushtuar në uljen e ndotjes mjedisore, si dhe ofrojmë shërbime të cilat janë të bazuara në gjendjen e çdo klienti dhe në analizën e shëndoshë financiare.

Fokusi ynë është ofrimi i shërbimeve për ndërmarrje të vogla dhe të mesme, sepse jemi të bindur që këto biznese krijojnë numrin më të madh të vendeve të punës dhe u japin një kontribut thelbësor ekonomive në të cilat operojnë. Duke ofruar shërbime të thjeshta depozituese për klientët privatë, si dhe duke investuar burime të konsiderueshme në edukimin financiar kemi për qëllim ta promovojmë kulturën e kursimit, e cila mund të sjellë qëndrueshmëri dhe siguri për familjet.

Aksionarët tanë presin një fitim të qëndrueshëm nga investimi në afat të gjatë dhe nuk janë të interesuar për maksimizimin e fitimit në afat të shkurtër. Ne bëjmë investime të mëdha në trajnimin e stafit, në mënyrë që të krijojmë atmosferë të kënaqshme dhe efikase të punës, si dhe të ofrojmë shërbime profesionale dhe të përshtatshme për klientët tanë.





Etika e biznesit dhe standardet mjedisore

Pjesë e misionit të përgjithshëm të grupit ProCredit është përcaktimi i standardeve në sektorët financiarë, në të cilët ne operojmë. Ne duam që të bëjmë ndryshim përmes grupeve të synuara, të cilave u shërbejmë përmes cilësisë së shërbimeve tona financiare dhe përmes etikës afariste. Operacionet e institucioneve ProCredit udhëhiqen nga këto parime:

1. Transparenca: Ne ofrojmë informata transparente për klientët tanë, për opinionin publik dhe për punonjësit tanë.

Për shembull, ne sigurohemi që klientët t'i kuptojnë plotësisht kushtet e kontratave të cilat ata i lidhin me ne dhe angazhohemi në edukimin financiar me qëllim që të ngremë vetëdijen e publikut për rreziqet e ofertave financiare jotransparente.

2. Kultura e komunikimit të hapur: Ne komunikojmë me njëri-tjetrin hapas, në mënyrë të drejtë dhe konstruktive. Ne i trajtojmë konfliktet në punë në mënyrë profesionale, duke punuar bashkërisht për të gjetur zgjidhje.

3. Përgjegjësia dhe toleranca shoqërore: Ne ofrojmë këshilla të shëndosha dhe me bazë të sigurt për klientët tanë. Para se të ofrojmë kredi për klientët tanë, ne vlerësojmë gjendjen e tyre ekonomike dhe financiare, potencialin e tyre të biznesit dhe kapacitetin e tyre për kthimin e kredisë në mënyrë që të shmanget mbiborxhi dhe t'u ofrojmë shërbime të përshtatshme financiare. Për më tepër, ne jemi të përkushtuar në trajtimin e të gjithë klientëve dhe punëtorëve me korrektësi dhe me respekt, pa marrë parasysh origjinën, racën, gjuhën, gjininë apo besimet e tyre fetare.

Ne gjithashtu sigurohemi se kërkesat e aplikuesve për financim vlerësohen në aspektin e përputhshmërisë me praktikën tonë etike, afariste. Asnjë kredi nuk është lëshuar për ata individë ose ato biznese, në qoftë se dyshohet se janë duke përdorur metoda të punës të cilat janë të pasigurta, të dëmshme për ambientin apo moralisht të papranueshme, veçanërisht shfrytëzimi i fëmijëve për punë.

4. Standarde të larta profesionale: Punëtorët tanë marrin personalisht përgjegjësi për kualitetin e punës së tyre dhe gjithmonë përpiqen për t'u ngritur profesionalisht.

5. Integritet dhe përkushtim personal: Sinqeriteti i plotë kërkohet në çdo kohë nga të gjithë punëtorët e grupit ProCredit dhe çdo mosrespektim i këtij parimi trajtohet shpejt dhe në mënyrë rigoroze.

Këto parime përfaqësojnë shtyllën kryesore të kulturës sonë korporative dhe aplikohen në mënyrë aktive gjatë operacioneve të përditshme. Ato reflektohen në Kodin e Mirësjelljes së ProCredit-it, e cila përkthen parimet e grupit në udhëzime praktike për personelin tonë.



Bordi Menaxhues

Ilir I. Aliu
Drejtor Gjeneral

Eriola Bibolli
Zëvendës Drejtoreshë Gjenerale

Informatat Themelore të bankës ProCredit

Aksionari	Shuma e vlerës nominale (EUR)	Numri i aksioneve	në %
ProCredit Holding	61,346,210	12,269,242	100
Totali	61,346,210	12,269,242	100

“ProCredit Holding” është kompania-prind e një grupi global bankash ProCredit, e cila operon në Evropën Lindore, në Amerikën Latine, si dhe në Gjermani. “ProCredit Holding” është themeluar si “Internationale Micro Investitionen AG” (IMI) në vitin 1998 nga kompania pioniere konsulente për zhvillimin financiar “Zeitinger Invest GmbH”.

“ProCredit Holding” është e përkushtuar për zgjerimin e qasjes në ofrimin e shërbimeve financiare në vendet në zhvillim dhe ekonomitë në transicion duke ndërtuar një grup bankash, të cilat janë udhëheqëse të ofrimit të shërbimeve financiare të drejta dhe transparente për bizneset shumë të vogla, të vogla dhe të mesme, si dhe për popullatën në vendet në të cilat operojnë. Përveç përmeshjes së nevojave të kapitalit të vartësve të saj, “ProCredit Holding” udhëheq zhvillimin e bankave ProCredit, kujdeset për sigurimin e menaxhmentit të lartë, si dhe mbështet bankat në të gjitha fushat e aktivitetit, duke përfshirë operacionet bankare, burimet njerëzore dhe menaxhimin e riskut. Ajo kujdeset që vlerat e korporatës ProCredit, praktikat më të mira ndërkombëtare, si dhe principet e Baselit II të Menaxhimit të Riskut të implementohen në gjithë grupin bashkë me standardet, gjithashtu të vendosura nga autoritetet gjermane të mbikëqyrjes.

“Zeitinger Invest GmbH” është aksionari udhëheqës, si dhe investitori strategjik në “ProCredit Holding”. “Zeitinger Invest GmbH” ka qenë forca shtytëse ndërmarrëse prapa grupit ProCredit që nga themelimi i bankave.

“ProCredit Holding” është partneritet publiko-privat. Përveç “Zeitinger Invest GmbH” dhe “ProCredit Invest”, aksionarët e tjerë privatë të “ProCredit Holding” përfshijnë fondacionin “Dutch DOEN”, fondin pensional amerikan TIAA-CREF, fondin amerikan të mikrofinancave “Omidyar-Tufts” dhe fondin investues zviceran “responsAbility”.

Aksionarët publikë të “ProCredit Holding” përfshijnë KfW-në (Bankën Promocionale Gjermane), IFC-në (sektori privat i Bankës Botërore), FMO-në (Banka Zhvillimore Holandeze), BIO-n (kompa-

nia investuese belge për vendet në zhvillim) dhe “Proparco”-n (kompania investuese dhe promovuese franceze për bashkëpunim ekonomik).

Forma ligjore e “ProCredit Holding” është e ashtuquajtura KGaA (Kommanditgesellschaft auf Aktien, ose në shqip një Partneritet me Përgjegjësi të Kufizuar). Kjo është një formë ligjore e përdorur shpesh në Gjermani, e cila në thelb mund të konsiderohet si një kompani aksionare në të cilën roli i bordit drejtues është marrë përsipër nga një partner i përgjithshëm dhe në të cilën partneri i përgjithshëm ka të drejtat e pëlqimit mbi vendime të caktuara të aksionarëve. Në rastin e “ProCredit Holding”, partneri i përgjithshëm është një kompani e vogël e veçantë, e cila zotërohet nga aksionarët kryesorë të “ProCredit Holding AG&CO”, KGaA-ja, “Zeitinger Invest GmbH”, “ProCredit Staff Invest”, DOEN-i, KfW-ja dhe IFC-ja. Struktura KGaA do t'i lejojë “ProCredit Holding” të rrisë kapitalin në të ardhmen pa ulur ndikimin e aksionarëve kryesorë në sigurimin e gjithë qëllimeve, në zhvillimin dhe në suksesin tregtar.

Segmentet Kyçe të Biznesit



Klientët e Biznesit

Banka ProCredit me përkushtim dhe profesionalizëm të lartë është përkushtuar në ofrimin e shërbimeve cilësore për klientët e biznesit të vogël dhe të mesëm, biznese të cilat bëjnë diferencën në krijimin e vendeve të reja të punës dhe në prosperitetin ekonomik.

Këtë vit, qasja e zhvilluar e Bankës për të menaxhuar relacionin me klientët e saj të biznesit dhe po ashtu profesionalizmi i këshilltarëve të biznesit kanë bërë që banka t'i kuptojë nevojat e klientëve, biznesin e tyre dhe kapacitetin financiar dhe të ofrojë shërbime adekuate financiare. Në linjë me strategjinë e bankës përveç shërbimeve të financimit ne kemi vënë një theks të veçantë në promovimin e shërbimeve tjera bankare, të cilat korrespondojnë me nevojat e klientëve tanë. Për t'i

plotësuar nevojat bankare të klientëve të biznesit ne gjatë tërë vitit kemi punuar në zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve tona në "Zonat 24/7", me qëllim që të ofrojmë bankim inovativ të shpejtë dhe të sigurt. E veçanta e këtyre zonave është se në to janë të vendosura pajisje të tilla të teknologjisë së lartë, të cilat i ofrojnë fleksibilitet dhe efikasitet të lartë klientëve të biznesit pa pasur nevojë të kufizohen nga orari i punës së Bankës. Në këto hapësira klientët e biznesit mund të bëjnë tërheqjen e fondeve 24 orë gjatë 7 ditëve të javës, deponim të realizimeve ditore në ATM, deponim të shumave më të mëdha në kasafortën bankare, si dhe të informohen në këndin informues apo edhe të kontaktojnë qendrën e thirrjeve.

Për më tepër, si rezultat i fokusit në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe zhvillimit të infrastrukturës bankare 99% të transaksioneve bankare

gjatë vitit 2016 janë realizuar përmes kanaleve elektronike. Kjo ka mundësuar që edhe këshilltarët e klientëve të biznesit të fokusohen më shumë në identifikimin e nevojave të klientëve dhe në ofrimin e shërbimeve kualitative dhe adekuate për klientët e biznesit.

Edhe gjatë vitit 2016 banka vazhdoi investimet në trajnimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të këshilltarëve të klientëve të biznesit me qëllim të ofrimit të trajtimit sa më cilësor dhe më profesional për klientët tanë. Kjo pasi banka i cilëson këshilltarët e klientëve të biznesit si pikë kyç në implementimin e strategjisë së saj zhvillimin e relacioneve profesionale afatgjate me klientët e biznesit.

Me qëllim të promovimit të rritjes së përgjithshme ekonomike edhe gjatë këtij viti fokus i veçantë i është dhënë promovimit dhe stimulimit të kredive investive, e posaçërisht ndaj kompanive prodhuese. Gjatë vitit 2016 mbi 35% e total-kredive të disbursuara ishin të destinuara si kredi investive. Në gjysmën e dytë të vitit kontribut në arritjen e objektivave dha edhe nënshkrimi i Marrëveshjes me Fondin Kosovar për Garantimin e Kredive, i cili siguron një pjesë të financimit të bizneseve.

Gjatë vitit 2016 banka ka zhvendosur fokusin nga ekspozimet kreditore \Rightarrow 30,000 euro dhe rritja në portofolin e biznesit gjatë vitit 2016 ishte mbi 5 milionë euro, ku volumi total i kredive dedikuar bizneseve në fund të vitit 2016 arriti në 333.7 milionë euro.

Bizneset e prodhuesve vendorë në lëmin e bujqësisë dhe të përpunuesve të ushqimeve janë një grup shumë i rëndësishëm për bankën ProCredit, ku si bankë duke u inkuorporuar brenda këtij zinxhiri bashkëpunues formojnë një partneritet të domosdoshëm për zhvillimin afatgjatë e të qëndrueshëm të sektorit bujqësor në përgjithësi. Në këtë segment gjatë vitit 2016 fokusi kryesisht ka qenë tek investimet kapitale bujqësore afatgjate si: zgjerimin e kapacitetit të fermave, ndërtimin e depove për ruajtjen e produkteve vendore, modernizimin e mekanizmit bujqësor (përmes partnerëve tanë të agrobiznesit), ngritjen e serave të reja, blerjen e tokës bujqësore, etj. Portofoli total i agro-kredive ndaj klientëve tanë strategjikë ka shënuar rritje për 2.2 milionë euro, duke arritur në 41.9 milionë euro. ProCredit si bankë, e cila kryen veprimtari të përgjegjshme bankare, ka fokus të

veçantë të vepruarit në pajtueshmëri me standardet mjedisore. Banka ka vazhduar me mbështetjen e klientëve të saj, të cilët kanë investuar përmes kredive të gjelbra - term ky që i karakterizon të gjitha shërbimet financiare për investim në kursim të energjisë, në burime të energjisë së ripërtërishe, si dhe masa tjera ekologjike miqësore.

Në vitet paraprake investime të tilla janë ndërmarrë më shumë nga klientët privatë, të cilët kanë investuar kryesisht në izolimin e shtëpive të tyre. Kurse gjatë vitit 2016 qëllimi ka qenë që sa më shumë të stimulohen klientët e bizneseve të ndërmarrin investime të tilla, me fokus të veçantë në avancimin e makinerive prodhuese dhe në masa që do të ulnin ndotjen e ujit apo të ajrit. Portofoli i kredive të gjelbra për klientë-biznesi arriti në 28.5 milionë euro, duke arritur pjesëmarrjen prej 8.5% në total në portofolin e financimit të këtyre klientëve.

Banka do të vazhdojë që t'i përshtatë dhe t'i zhvillojë shërbimet bankare në funksion të bizneseve me qëllim që t'i ndihmojë biznesit të zgjerohet dhe të veprojë në mënyrë më efikase dhe të sjellin qëndrueshmëri e partneritet afatgjatë. Përveç përkrahjes së investimeve afatshkurtra dhe afatmesme të bizneseve, fokusi ynë i veçantë për vitin 2017 do të vazhdojë të jetë në përkrahjen dhe stimulimin e investimeve afatgjate, e në veçanti në përkrahjen e bizneseve prodhuese. Këto elemente të kombinuara me përvojën e specializuar të këshilltarëve të biznesit janë bazat e modelit tonë të një biznesi të suksesshëm. Synim i bankës sonë mbetet të qenit "Bankë partnere" për klientët e biznesit të vogël dhe të mesëm.



Klientët Privatë

Banka jonë edhe gjatë vitit 2016 ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të dizajnuar shërbime të avancuara bankare, si dhe ka bërë investime konstante në shërbime elektronike, në mënyrë që klientëve tanë t'u ofrohet mundësia sa më e lehtë dhe më efikase për menaxhimin e financave të tyre. Njëjtë, sikurse vitet e kaluara, edhe këtë vit banka jonë ka qenë fuqishëm e orientuar që të bëjë përmirësime infrastrukturore dhe organizative me të njëjtin qëllim.

Duke qenë se investimet dhe përmirësimet në fjalë kanë ndihmuar automatizimin e shumicës dërrmuese të shërbimeve të saj qoftë pas implementimit të konceptit "Zona 24/7", qoftë pas azhurnimit të vazhdueshëm të platformës sonë të bankimit elektronik, në këtë mënyrë banka jonë ka krijuar

hapësirën e nevojshme që 41 pikat tona të shërbimit të jenë plotësisht të orientuara në ofrimin e këshillave profesionale, në edukimin financiar dhe në kredidhënien e përgjegjshme gjithmonë në harmoni me vizionin, misionin, strategjinë dhe politikën e bankës.

Banka ProCredit ka vazhduar mbështetjen e fuqishme në realizimin e projekteve investive të klientëve të saj privatë, projekte këto të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë i kontribuojnë ngritjes së cilësisë së jetesës të klientëve tanë. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2016 banka ProCredit fokus të veçantë kishte financimin e klientëve, të cilët investuan në blerjen e patundshmërive, me ç'rast portofoli i kredive hipotekare shënoi rritje prej 50% në raport me vitin paraprak.

Qasja e përgjegjshme në mbrojtjen mjedisore



është pjesë e rëndësishme e përgjegjësisë shoqërore të bankës ProCredit dhe vlerë e integruar në filozofinë tonë bankare. Në këtë kontekst, banka ProCredit edhe gjatë këtij viti ka vazhduar me mbështetjen e palëkundur të klientëve të saj, të cilët kanë investuar në rritjen e masave që i kontribuojnë mbrojtjes së mjedisit dhe kursimit të energjisë. Zhvillimi i portofolit të eko-kredive gjatë vitit 2016 ka qenë fokus i veçantë dhe e njëjta qasje do të aplikohet edhe përgjatë vitit 2017. Eko-kreditë nënkuptojnë të gjitha aktivitetet financiare për investim në kursim të energjisë, investim në burime të energjisë së ripërtërishme dhe investime të tjera ekologjikisht miqësore.

Vlen të theksohet se edhe viti 2016 u karakterizua nga një konkurrencë e fortë në fushën e kreditimit të klientëve privatë. Kundrejt këtij fakti, banka ProCredit arriti që cilësinë e portofolit kreditor të

klientëve privatë ta përmirësojë edhe më shumë. Përderisa portofolin e kredive të përbërë nga kreditë hipotekare, eko-kreditë, kreditë për renovim, kreditë për shkollim, kreditë private, mbitërheqjet dhe kartelat e kreditit, ta mbajë në nivel mjaft të mirë dhe me rritje të lehtë krahasuar me vitin paraprak.



Depozitat e klientëve privatë

Banka ProCredit edhe këtë vit dëshmoi besueshmërinë e fituar nga klientët e saj, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e depozitave, pavarësisht strukturës së tyre, qofshin ato në depozita me afat, kursime apo edhe në llogari rrjedhëse. Depozitat e klientëve privatë ende vazhdojnë të përfaqësojnë shumicën dërrmuese të depozitave të bankës, që kapin vlerën prej rreth 76% të vlerës totale të vitit 2016. Në anën tjetër, sa i përket klientëve privatë banka ka vazhduar rregullisht të theksojë rolin e kursimeve, pasi ato janë një

faktor i rëndësishëm për t'ju ofruar klientëve tanë stabilitet financiar. Edukimi financiar në këtë aspekt ka vazhduar qoftë përmes këshillimit të rregullt nga këshilltarët tanë për klientë, qoftë përmes takimeve të rregullta të cilat i kemi mbajtur përgjatë vitit me grupe më të vogla klientësh.

Kanalet elektronike të bankimit

Në fillim të vitit 2016 u përfundua me sukses projekti i “Zonave 24/7”, me ç’rast u zgjerua rrjeti i “Zonave 24/7” dhe mundësitë e vetëshërbimit për klientët.

Me rritjen e numrit të shërbimeve, të cilat mund të kryhen në zona, u rrit edhe më tej mundësia që klientët të shërbehen në çdo kohë përmes shërbimeve elektronike. Derisa në të kaluarën shërbimet elektronike konsideroheshin kanale alternative të bankimit për transaksione, ato tani u bënë mënyra primare dhe e preferuar e bankimit me “ProCredit Bank”.

Pavarësisht performancës së kënaqshme me tërheqje në ATM në vitin paraprak, u vlerësua si e nevojshme që të shtohen mundësitë e llojeve të reja të transaksioneve të cilat mund të realizohen në zona dhe në bankomate në përgjithësi. Në këtë drejtim, duke filluar nga muaji shkurt banka implementoi mundësinë e tërheqjes edhe në vlera nga 2.000 euro deri në 10.000 euro. Me këtë zhvillim dhe me mundësimin e tërheqjeve edhe nga llogaritë tjera, përveç asaj rrjedhëse dhe të kursimit, tani banka është e gatshme t’i përmbushë edhe kërkesat e avancuara të klientëve.

Duke filluar nga çereku i dytë i vitit në “Zona 24/7” kartelëmbajtësve u është mundësuar edhe deponimi në llogarinë e tyre të kursimit, si dhe në llogari të klientëve tjerë të bankës “ProCredit”. Në fund të vitit funksionet e deponimit u kompletuan me lansimin e shërbimit për deponim të monedhave në bankomate të caktuara. Ndërsa për klientë që nuk janë të pajisur me kartelë u zhvillua shërbimi për deponim përmes kodit, me të cilin u ofrojmë shërbim të shpejtë këtyre klientëve. Kartela e kursimeve e lëshuar më vonë gjithashtu shërbeu për ta kompletuar gamën e shërbimeve të ofruara për të gjithë klientët e saj. Gjatë vitit kishte shumë zhvillime të dizajnuara pikërisht për t’u kursyer kohë klientëve të biznesit dhe për t’ua përmirësuar rrjedhën e punës. Në bankomat u shtua opsioni që agjentët e bizneseve ta deklarojnë në detaje pazarin ditor, proces që lehtëson barazimin e parave të gatshme për biznese. Për deponime në vlera më të mëdha në kasafortën e deponimit u shtua mundësia e reflektimit të deponimit përmes “E-Banking” para arritjes në “Zonë 24/7” apo në një POS-terminal të dedikuar në zonë për të deklaruar shumën e deponuar. Gjithashtu, duke filluar nga muaji prill bizneseve u është mundësuar iniciimi i

transfereve nga llogaritë e linjës kreditore në “E-Banking”, shërbim që edhe më shumë lehtëson punën me bankë për biznese.

Në çerekun e fundit të vitit banka doli në treg me kartelën “Debit MasterCard”, kartelë e pajisur me teknologjinë “Contactless”, e cila mundëson blerje dhe pagesa më të shpejta pa kontakt. Me këtë kartelë “ProCredit Bank” u bë banka e parë në vend që përkrah pagesa të shpejtuara për vlera të vogla. Rrjeti i bankës u pasurua me POS-terminale me teknologji “Contactless” dhe tani jemi të pozicionuar mirë që ta përkrahim më gjerësisht këtë lloj të pagesave me kartelë, duke plotësuar nevojën e klientëve që edhe për pagesa të vogla të paguajnë shpejt përmes kartelës “MasterCard Debit” në POS-terminale pa kontakt.

Menaxhimi i rrezikut

Menaxhimi i rrezikut kreditor për vitin 2016

Thelbi i veprimtarisë afariste të bankës ProCredit është përqendrimi te kredidhënia për klientët e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe për individët privatë të cilët kanë dëshirë të kursejnë. Duke marrë parasysh fokusin e biznesit të bankës sonë, për rrjedhojë, rreziku kreditor klasik është rreziku më domethënës me të cilin përballet banka dhe që përbën pjesën më të madhe të rrezikut në kuadrin e llogaritjes së kapacitetit të tolerancës së rrezikut. Parimet themelore të bankës për menaxhimin e rrezikut kreditor jepen në Politikën e Bankës për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor dhe në Politikën për Vlerësimin e Kolateralit, të cilat janë përshtatur në harmoni me politikat e grupit të ProCredit-it. Këto politika së bashku pasqyrojnë përvojën që ka grupi me operacionet e suksesshme të huadhënies në ekonomitë në zhvillim dhe në tranzicion. Këto dokumente janë në harmoni të plotë me ligjet dhe rregulloret në Kosovë. Gjatë procesit të menaxhimit të rrezikut kreditor individual, banka zbaton parime të caktuara me qëllim që të zvogëlojë rrezikun kreditor. Në këto parime përfshihet, përmes analizimit intensiv të kapacitetit debitor të klientëve të bankës, shmangia e futjes së klientëve në mbiborxhe, monitorimi i ekspozimeve kreditore, menaxhimi i ekspozimeve kreditore me problem, zbatimi i proceseve të dizajnuara me kujdes dhe të mirëdokumentuara, zbatimi i parimit “Të katër syve”, ndërtimi i marrëdhënieve personale dhe afatgjata me klientët dhe ruajtja e kontakteve të rregullta, si dhe investimi te punonjësit e mirëtrajnuar dhe tepër të motivuar. Për më tej, analiza e kujdesshme e portofolit të kredive përbën njëri prej kompetencave më të rëndësishme për bankën tonë. Kjo është gjithmonë e më e rëndësishme dhe relevante për bankën tonë, si dhe për grupin, nëse marrim parasysh mjediset makroekonomike, shumëdinamike, në të cilat kryejmë aktivitetet tona dhe strategjinë afariste të ndryshuar që kemi. Për pasojë, këtë vit banka ka nxjerrë disa raporte dhe shkresa përcjellëse lidhur me identifikimin e rrezikut kreditor që vjen nga klientët individualë dhe në nivelin e portofolit në fazën e hershme (indiktorët për paralajmërim të hershëm). Megjithatë, këto raporte janë në fazën e testimit, ndërkohë që rezultatet fillestare tregojnë se ato përbëjnë një vlerë të konsiderueshme të shtuar në menaxhimin e rrezikut kreditor.

Gjithashtu, rreziku kreditor zvogëlohet nga fakti se portofoli kreditor i bankës është tepër i diversifikuar dhe çdo përqendrim i mundshëm i rrezikut kreditor testohet maksimalisht për ndikimin që mund të ketë në aftësinë e bankës për ta përballuar atë. Për sa u përket grupeve të klientëve, ky diversifikim përfshin sektorët ekonomikë, grupet e klientëve, bizneset e mesme, të vogla dhe shumë të vogla, si dhe individët privatë e institucionet. Një tjetër karakteristikë e qasjes së bankës është se ajo kërkon t’u ofrojë klientëve produkte të thjeshta dhe që kuptohen lehtë. Kjo sjell një shkallë të lartë transparence jo vetëm për klientin në fjalë, por edhe nga pikëpamja e menaxhimit të rrezikut. Niveli i lartë i diversifikimit së bashku me produktet dhe procedurat e thjeshta dhe transparente të bankës e zvogëlojnë profilin e përgjithshëm të rrezikut të saj.

Kur bëhet trajtimi i kategorive të ndryshme të klientëve dhe i ekspozimeve kreditore zbatohen metoda të ndryshme të menaxhimit të rrezikut kreditor. Aspektet kryesore të proceseve kreditore për klientët afaristë, ata privatë dhe për kategoritë e ndryshme të ekspozimeve kreditore janë: ndarja e detyrave për ekspozimeve të vogla dhe të mesme kreditore, procese të standardizuara për huadhënien për klientë privatë, kriteret për vendimet e ekspozimeve kreditore dhe kërkesat e ndryshme për kolateral, të mbështetura në dokumentacionin, shumat dhe historikun kreditor të klientit. Gjithashtu, vlerësimi i kolateralit kryhet nga kompani të jashtme të licencuara, gjë që e zvogëlon rrezikun e vlerësimit të vlerës së kolateralit.

Duke marrë parasysh faktin se shumica dërrmuese e kredive të bankës janë të ripagueshme me anë të kësteve mujore, mosarritja e huamarrësit për të respektuar afatin e pagesës trajtohet si shenjë fillestare e mundësisë së mospagimit në kohë dhe nxit menjëherë reagimin e bankës. Procesi i ri i monitorimit me indikatorë të paralajmërimit të hershëm i mundëson bankës t’i përgjigjet menjëherë çdo shenje të ndonjë mundësie për mospagesë në kohë. Pavarësisht kësaj, gjatë pjesës më të madhe të vitit 2016 indikator i kyç për cilësinë e portofolit kreditor dhe për matjen e rrezikut kreditor klasik mbeti PAR₃₀ ditë, nëse marrim parasysh vetëm kalimin e afatit të pagesës së interesit apo kryegjësë për më shumë sesa 30 ditë. Megjithatë, gjatë këtij viti

kriteret e reja, të tilla si: numri mesatar i ditëve kur pagesa është vonuar gjatë tre muajve të fundit dhe ditët në vonesë gjatë muajit dhe jo vetëm në fund të muajit përfshihen në matjen e portofolit në rrezik. Sidoqoftë, këto kritere janë ende në fazën e testimit dhe gjatë vitit të ardhshëm kemi ndërmend të prezantojmë pragje për treguesit e rinj që përmendëm më lart.

Në vitin 2016 numri i përgjithshëm i PAR₃₀-s i bankës është zvogëluar. Rënia më e thuktë e PAR-it ndodhi në kategorinë e kredive për biznese, me shumë më të madhe sesa 250,000 euro (ekspozimet e bizneseve të mesme) dhe kreditë e lëshuara për familje private, meqenëse ndikimi i vazhdueshëm nga cenueshmëria e institucioneve financiare të bankimit ndaj kreditimit, ndërkohë që vazhdon përpjekjet në kuadrin e menaxhimit të cilësisë së portofolit. Për rrjedhojë, raporti i kredive joperformuese të Bankës (KJP) është përmirësuar vazhdimisht dhe është shumë më e ulët sesa KJP-ja e sektorit.

Banka ProCredit në Kosovë ndjek një qasje konservative ndaj provizionimit për humbjet nga kreditë. Toleranca për ekspozimet individuale të rëndësishme të cilat kanë shenja dëmtimi vlerësohen veç e veç dhe herë pas here. Ndërkohë, për ekspozimet e tjera rezerva minimale për KJP-në pasqyron probabilitetin e mospagesës në kohë të portofolit dhe humbja që shkaktohet nga mospagesa në kohë. Për pasojë, norma e mbulimit në fund të vitit ishte 152% (provizionimet për humbjet nga kreditë, sipas BQK-së, si përqindje e PAR₃₀ ditë), ndërkohë që norma e mbulimit të KJP-së ishte 171.8%. Kreditë që konsiderohen si të parikuperueshme shlyhen vazhdimisht, ndërkohë që masat e rikuperimit zbatohen me rreptësi.

Menaxhimi i rrezikut të ekspozimit ndaj palëve tjera

Me qëllim të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, si dhe për qëllime të tjera operuese, banka ProCredit investon dhe mban një pjesë të likuiditetit të saj tek palët e tjera, duke përfshirë emetuesit e letrave me vlerë. Me këtë rast, banka i ekspozohet rrezikut të mosgatishmërisë apo paaftësisë së këtyre palëve për t'i përmbushur obligimet e tyre ndaj bankës.

Ky rrezik menaxhohet nga banka në mënyrë aktive dhe të kujdesshme përmes politikave të saj të menaxhimit të rrezikut të palëve tjera, politikave të menaxhimit të likuiditetit, politikave të thesarit, politikave të investimeve, etj. Në këto politika dhe në procedura të tjera të bankës definohen në detaje proceset e përzgjedhjes së kujdesshme të palëve tek të cilat banka ekspozohet, përcaktohen limitet e ekspozimit, tipat e transaksioneve të lejuara, mënyrat e kontrollimit dhe monitorimit, rregullat e procesimit të tyre, etj.

Banka ProCredit ka një tolerancë relativisht të ulët ndaj këtij rreziku dhe nuk zhvillon aktivitete tregtuese spekulative. Palët e tjera të përzgjedhura, parimisht janë institucione me klasifikim të lartë kreditor, reputacion të mirë dhe me qëndrueshmëri të lartë financiare. Në parim, asnjë ekspozim ose marrëveshje nuk mund të realizohet pa përcaktuar paraprakisht një limit. Procesi i vendosjes së limiteve bëhet duke u bazuar në analizë të thukët nga banka, të cilat rishikohen në baza vjetore. Për më tepër, politikat dhe procedurat e bankës janë në përputhje me rregulloret e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit dhe financimit

Rreziku i likuiditetit nënkupton rrezikun që banka mund të mos jetë në gjendje t'i përmbushë detyrimet aktuale dhe të ardhshme të saj në mënyrë të plotë ose në kohën e duhur. Rreziku i financimit nënkupton rrezikun se financimi shtesë në rast nevojë mund të mos arrihet apo mund të merret vetëm me norma të interesit shumë të larta. Banka ProCredit menaxhon këto rreziqe përmes politikave dhe procedurave të saj në përputhje me kërkesat e autoriteteve rregullative në vend. Kontrollimi dhe zvogëlimi i rrezikut të likuiditetit mbështetet nga modeli i biznesit të bankës. Nga njëra anë, portofoli i kredisë karakterizohet nga një numër i madh i ekspozimeve afatshkurtra dhe afatmesme për klientët. Shumica e kredive kanë plane kthimi në formë anuiteti dhe kanë cilësi të lartë. Nga këndvështrimi i rrezikut të likuiditetit, kjo ndihmon në menaxhimin e saj pasi rrjedhat hyrëse të parasë jenë më të parashikueshme. Nga ana tjetër, depozitat e klientëve janë burimi ynë kryesor i financimit, ndërsa përdorimi i instrumenteve të tregjeve financiare është i ulët.



Si pjesë e menaxhimit të likuiditetit banka ka definuar dhe ka përcjellë vazhdimisht indikatorët e saj të likuiditetit. Gjithashtu, testet e stresit të likuiditetit zhvillohen rregullisht duke u bazuar në skenarë të definuar, të cilët ndihmojnë bankën për t'i analizuar pozicionet e saj të likuiditetit në rast të tronditjeve potenciale të brendshme apo të jashtme. Gjatë vitit 2016 banka ProCredit ka pasur një nivel shumë të kënaqshëm të likuiditetit. Në fund të vitit 2016 indikator i mjeteve likuide në raport me depozitat ka qëndruar në 37% (sipas definicioneve rregullative lokale), që paraqet një situatë të kënaqshme të likuiditetit. Banka po ashtu e konsideron rrezikun e financimit të jetë i ulët për shkak të mbështetjes në larminë e depozitave të konsumatorëve, si dhe për faktin që banka vazhdon të ketë qasje në financim nga burime të ndryshme ndërkombëtare.

Menaxhimi i rrezikut të valutës

Rreziku i valutës së huaj nënkupton rrezikun e efekteve negative në rezultatet financiare dhe në mjaftueshmërinë e kapitalit të bankës të shkaktuara nga ndryshimet në kurset e këmbimit në treg. Rreziku i valutës së huaj menaxhohet nga banka ProCredit në pajtim me politikën e menaxhimit të rrezikut të valutës së huaj, që respekton kërkesat e Rregullores së BQK-së. Pozitat e valutës menaxhohen në baza ditore dhe normat e këmbimit të valutave të huaja monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.

Banka ProCredit ka një nivel të ulët të ekspozimit ndaj rrezikut të valutës sepse ajo nuk mban pozitat e hapura të valutës në mënyrë spekulative. Po ashtu banka ka të përcaktuara limite të lejuara për këtë rrezik, të cilat nuk janë tejkualuar

asnjëherë gjatë vitit 2016. Gjatë këtij viti banka ka arritur t'i mbajë pozicionet e hapura valutore mjaft ulët me një mesatare prej 0.21% në raport me kapitalin e klasës së parë sipas definicioneve të BQK-së.

Menaxhimi i rrezikut të normës së interesit

Rreziku i normës së interesit vjen nga ndryshimet strukturore midis maturiteteve të rivlerësimit të mjeteve dhe detyrimeve. Kjo mund ta ekspozojë bankën ndaj rrezikut që kostot e financimit mund të rriten, ndërkohë që kthimi nga asetet mund të mbetet i njëjtë, apo që kthimi nga asetet ulët duke mos u reflektuar në uljen e kostove të financimit për një kohë më të gjatë, duke rezultuar në zvogëlime të margjinës.

Edhe për këtë rrezik banka ka në fuqi politikën përkatëse. Banka bën vazhdimisht analizat e hendekut të maturitetit (duke u bazuar në ricaktimin e çmimeve) në mes të mjeteve dhe detyrimeve. Banka po ashtu aplikon stres-teste përmes simulimit të lëvizjeve të normave të interesit për të matur ndikimin në vlerën ekonomike dhe në të ardhurat nga interesi. Rezultatet e analizave raportohen rregullisht në Komitetin e Menaxhimit të Rrezikut në nivel të Bankës dhe në bordin drejtues. Përgjatë 2016-s ekspozimi i rrezikut të normës së interesit ishte brenda limiteve të miratuara

Adekuatshmëria e kapitalit

Adekuatshmëria e kapitalit të bankës kalkullohet në baza të rregullta dhe raportohet tek menaxhmenti i bankës përmes Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut, bashkë me parashikimet e ardhshme që të sigurohet pajtueshmëri me kërkesat rregulative të adekuatshmërisë së kapitalit. Menaxhimi i adekuatshmërisë së kapitalit bëhet duke u mbështetur në politikën e bankës dhe në përputhje me Rregulloren e Bankës Qendrore mbi Adekuatshmërinë e Kapitalit.

Gjatë tërë vitit 2016 banka ka qenë mirë e kapitalizuar, duke mbajtur raportet e adekuatshmërisë së kapitalit mbi limitet e parapara me politika të bankës dhe rregulla bankare. Gjatë vitit 2016 raporti i adekuatshmërisë së totalit të kapitalit

sipas definicioneve të rregullatorit vendor ishte mesatarisht 18.5%, që është mbi minimumin rregullator prej 12%. Në anën tjetër, raporti i adekuatshmërisë së kapitalit të klasës së parë gjatë vitit 2016 ishte mesatarisht 16.1%, që gjithashtu tejkalon minimumin rregullator lokal prej 8%.

Gjatë vitit 2016 agjencia "FitchRatings" ka përmirësuar klasifikimin e përgjithshëm afatgjatë kreditor të bankës ProCredit në "BB-" nga "B+", sa ishte në vitin 2015.

Menaxhimi i rrezikut operacional dhe i mashtrimit

Rreziku operacional definohet si rreziku nga humbja si rezultat i proceseve joadekuate internale, rreziku nga njerëzit, si dhe nga sistemet dhe/ose ngjarjet nga jashtë. Ky definim gjithashtu përfshin edhe rrezikun ligjor. Banka menaxhon rrezikun operacional përmes politikave të dedikuara për këto rreziqe që përfshijnë politikën e menaxhimit të rreziqeve operacionale, atë për parandalimin e mashtrimeve, politikën e sigurisë së informatave, politikën e nënkontraktimit, etj. Menaxhimi i këtij rreziku është i mbështetur nga trajnimet intensive të stafit në të gjitha nivelet, që ka dëshmuar të jetë efektiv në zvogëlimin dhe në mënjanimin e rrezikut operacional.

Për të zvogëluar rrezikun operacional dhe atë të mashtrimit, të gjitha proceset kryesore të bankës janë të dokumentuara në mënyrë të duhur dhe përmbajnë mekanizmat e nevojshëm të kontrollit. Vëmendje e madhe i kushtohet integritetit personal përmes zbatimit të Kodit të Mirësjelljes dhe programeve të trajnimit të dizajnuara me qëllim të promovimit të një kulture të transparencës dhe vetëdijes së rrezikut. Njohuritë mbi rrezikun operacional, të mashtrimit dhe të sigurisë së informacionit, si dhe kanalet për raportimin e ngjarjeve të këtyre rreziqeve janë pjesë e trajnimeve të rregullta të stafit.

Banka përdor bazën e të dhënave të ngjarjeve të rrezikut përmes së cilës sigurohet që rreziqet operacionale dhe rastet e mashtrimeve të adresohen në mënyrë sistematike, duke i dokumentuar masat korrektuese dhe preventive.

Si pjesë e kornizës së saj të menaxhimit të rrezikut operacional dhe të mashtrimit banka bën vlerësime të rregullta të proceseve për identifikimin e rreziqeve dhe mungesave potenciale të kontrollit, që mund të zvogëlohen dhe të kontrollohen me masa të duhura. Për më tepër, ndryshimet materiale në proceset dhe shërbimet e bankës, të reja apo aktuale, kalojnë përmes një procesi të rishikimit dhe aprovimit të rreziqeve. Gjithashtu, indikatorët kyç të rrezikut monitorohen rregullisht nga banka.

Parandalimi i shpëlarjes së parave

Banka ProCredit në Kosovë synon të kontribuojë në zhvillimin e sektorit social dhe ekonomik, duke i vënë theks të veçantë përgjegjësisë sociale gjatë krijimit të marrëdhënies me klientë. Banka mbështet fuqishëm luftën kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit dhe nuk krijon marrëdhënie bankare me klientë, aktiviteti i të cilëve bie ndesh me vlerat tona etike. Duke u bazuar në këto parime, ne kemi vënë rregulla strikte për t'i luftuar dukuritë e tilla negative.

Për t'u siguruar që institucioni ynë është në përputhje të plotë me kërkesat dhe detyrimet e përcaktuara në legjislacionin e Kosovës, rregulloret, rregullat dhe udhëzimet e industrisë bankare, ne kemi hartuar politika dhe procedura kundër shpëlarjes së parave. "ProCredit Bank", përpos politikës lokale, ka implementuar edhe politikën e grupit për luftimin e shpëlarjes së parave, e cila përmbush kërkesat e legjislacionit gjerman dhe atij të BE-së.

Gjithashtu, banka ProCredit aplikon rekomandimet e FATF-së mbi vlerësimin e rrezikut duke analizuar rreziqet që kanosen nga shpëlarja e parave dhe duke marrë masa adekuate lidhur me to. Banka po ashtu përdor edhe softuer të sofistikuar, i cili mundëson detektimin e transaksioneve potencialisht të dyshuara dhe pajtueshmëri-në me sanksione ndërkombëtare.

Në bankën tonë përgjegjësia për luftimin e shpëlarjes së parave ushtrohet nga Njësia Kundër Shpëlarjes së Parave (Njësia KSHP). Përveç zyrtarëve në Njësinë KSHP, i gjithë stafi i bankës pranon trajnime intensive (kombëtare e ndërkombëtare) për më të rejat nga fusha e luftimit të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

Punëtorët dhe zhvillimi i tyre



Në linjë me misionin dhe vizionin e saj, banka ProCredit ka vendosur që me përkushtim të lartë t'i arrijë objektivat e vendosura në operacionet e biznesit. Këto objektiva nuk mund të arrihen pa një skuadër punonjësish të motivuar, të dedikuar dhe të mirëtrajnuar, prandaj banka investon vazhdimisht në zhvillimin e burimeve njerëzore. Duke filluar nga një proces transparent dhe të drejtë të rekrutimit dhe përzgjedhjes, kandidatët dhe punonjësit e bankës ProCredit trajtohen njëjtë dhe me mundësi të shumta trajnimi sepse besojmë se kompetencat dhe përkushtimi i personelit është rëndësi thelbësore për ofrimin e shërbimit me cilësi të lartë për klientët, në mënyrë të përgjegjshme. Për këtë arsye, investimet në trajnimin dhe në zhvillimin e vazhdueshëm të punonjësve janë të një rëndësie të veçantë.

Investimi për trajnimin dhe zhvillimin e personelit ndahet në tri segmente kryesore, siç janë: akademitë dhe qendrat e gjuhëve të ProCredit-it, trajnimet e specializuara dhe trajni-met e tjera

Akademitë dhe qendrat e gjuhëve të grupit ProCredit

Trajnime të avancuara mbahen në dy akademitë e grupit ProCredit në Furth, Gjermani, siç janë: Akademia e Bankierëve (program katërbëdhjetëjavor) dhe Akademia për Menaxherët (program trevjeçar me gjysmë orari). Në vitin 2016, 14 punonjës diplomuan nga këto akademi: nëntë nga Akademia e Bankierëve dhe pesë nga Akademia e Menaxherëve. Aktualisht, 32 punonjës të tjerë janë duke vijuar studimet në këto akademi (14 në Akademinë e Bankierëve dhe 18 në Akademinë e Menaxherëve).

Gjithashtu, kurset e gjuhës angleze ofrohen për personelin në nivele të ndryshme, pasi që gjuha angleze është gjuhë e dytë e punës në bankën ProCredit. Vetëm këtë vit 70 punonjës kanë qenë pjesëmarrës në shkollat për kurset e gjuhës angleze, 37 në Qendrën e Gjuhëve në Veles, Maqedoni, dhe 33 në Qendrën e Gjuhëve në Furth, Gjermani.

Trajnimet e specializuara dhe trajnimet tjera

Trajnime tjera që janë mbajtur gjatë vitit 2016 kanë qenë rreth 25 lloje të ndryshme të trajnimeve të specializuara, si dhe të kurseve tjera lokale.

Mbi të gjitha, banka ProCredit në Kosovë ka investuar afërsisht 1 milion euro në trajnim dhe zhvillim të personelit në vitin 2016, që përkthehet në një mesatare vjetore të investimit prej rreth 2,000 eurosh për punonjës. Ndërkaq, numri mesatar i ditëve të trajnimit në Kosovë dhe jashtë saj është 6,500, ku mesatarisht 7 ditë trajnimi janë ofruar për punonjës në vitin 2016.

Këtë vit banka ProCredit ka inauguruar Qendrën Rajonale të Trajnimeve, e cila është e ndërtuar në Prevallë të Prizrenit e që do të ofrojë trajnime të avancuara, të cilat janë të dizajnuara për t'i thelluar dhe për t'i përditësuar njohuritë e specializuara të punonjësve të bankave ProCredit si në Kosovë, ashtu edhe në rajon në fushat e tyre të veprimtarisë dhe gjithashtu për t'i rritur aftësitë e tyre analitike dhe ndërpersonale.

Zgjedhja e Kosovës për ndërtimin e kësaj Qendre, investim ky mbi 3.2 milionë euro i bankës sonë, tregon përkushtimin e grupit ProCredit në avancimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve humane dhe vendosmërinë për zhvillimin e sektorit bankar dhe zhvillimit ekonomik të vendit. Qendra Rajonale e Trajnimeve është objekti i parë në vend që është ndërtuar me standarde të larta ekologjike, duke qenë se janë bërë investime në: panele fotovoltaike, panele diellore për ngrohje të ujit, izolim termik, impiante për trajtimin e ujërave. Qendra ka një sipërfaqe prej 3,300 m², 4 klasa mësimi të pajisura me të gjitha mjetet për trajnim, 33 dhoma gjumi që sigurojnë kapacitet optimal, restorant dhe mundësi për sporte rekreative.

ProCredit Entry Programme

Një rëndësi e veçantë i jepet edhe punonjësve të rinj që i bashkëngjiten bankës. Për këtë arsye, banka ProCredit ka dizajnuar programin "ProCredit Entry Programme", i cili po implementohet që nga viti 2011. Deri në fund të vitit 2016 nga banka ProCredit në Kosovë janë diplomuar 17 grupe me rreth 195 kandidatë, të cilët e kanë përfunduar

me sukses programin.

"ProCredit Entry Programme" është program ndërkombëtar, i cili realizohet në gjuhën angleze e që bashkon kandidatë nga vendet e regjionit. Ky program zgjat 6 muaj dhe ofron mundësi unike për zhvillim gjithëpërfshirës dhe punësim për kandidatë të profileve të ndryshme.

Ndërtimi i marrëdhënieve

Si në vitet e kaluara, mundësitë për punë praktike janë ofruar dy herë në vit, gjatë sezonit të verës dhe të dimrit, për studentë nga universitetet publike dhe ato më prestigjioze private. Pasi puna praktike është pjesë e detyrueshme e kurrikulës së shumicës së universiteteve në Kosovë, duke ofruar mundësi për punë praktike për studentët, banka ProCredit luan rol të rëndësishëm me kontributin e saj në përpjekjet e edukimit financiar në vend.

Në vit rreth 100 studentëve u ofrohet punë praktike tremujore në bankë, me qëllim që t'u ndihmohet t'i zhvillojnë në praktikë njohuritë e marra në fakultet në mënyrë që të integrohen më lehtë në tregun e punës.



Pasqyra Financiare

Pasqyra Financiare deri më 31 Dhjetor 2016

Informatat e përgjithshme

Bordi i Drejtorëve

Z. Borislav Kostadinov, Kryetar

Znj. Helen Alexander

Z. Rainer Ottenstein

Z. Jordan Damchevski

Z. Luan Gashi

Z. Ilir Aliu

Zyra e regjistruar

Bulevardi Xhorxh Bush, Nr.26

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës

PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR.....	24
PASQYRA E FITIMIT OSE E HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA PËRMBLEDHËSE.....	26
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	27
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË.....	28
PASQYRA E NDRYSHIMIT NË EKUITET.....	29
1. HYRJE.....	30
2. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL.....	30
3. STANDARDET E REJA, NDRYSHIMET DHE INTERPRETIMET ENDE TË PAMIRATUARA.....	37
4. GJYKIMET KRITIKE KONTABËL DHE BURIMET KYÇ TË PASIGURISË SË PËRLLOGARITJES.....	40
5. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR.....	41
6. VLERA E DREJTË E INSTRUMENTEVE FINANCIARE.....	61
7. TË ARDHURA NETO NGA INTERESI.....	63
8. TË ARDHURA NETO NGA TARIFAT DHE KOMISIONI.....	63
9. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE DHE TË TJERA OPERATIVE.....	64
10. SHPENZIMET E TATIMIT NË FITIM.....	64
11. MJETET MONETARE DHE GJENDJA ME BANKAT QENDRORE.....	66
12. KREDI DHE PARADHËNIE PËR BANKA.....	66
13. KREDI DHE PARADHËNIE PËR KLIENTË.....	66
14. AKTIVE FINANCIARE TË VLEFSHME PËR SHITJE.....	67
15. AKTIVET E PATRUPËZUARA.....	68
16. PRONA DHE PAJISJSET.....	68
17. AKTIVE TË TJERA FINANCIARE.....	69
18. AKTIVE TË TJERA.....	69
19. DETYRIMET NDAJ BANKAVE.....	69
20. DETYRIMET NDAJ KLIENTËVE.....	69
21. HUAZIMET DHE BORXHI I VARUR.....	70
22. DETYRIMET TJERA FINANCIARE.....	70
23. DETYRIMET TJERA.....	70
24. KAPITALI AKSIONAR DHE REZERVAT.....	70
25. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA.....	71
26. ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT.....	72
27. NGJARJET PAS PËRFUNDIMIT TË PERIUDHËS RAPORTUESE.....	73



Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar Aksionarëve dhe Menaxhmentit të Procredit Bank sh.a.

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, gjendjen financiare të Procredit Bank sh.a. ("Banka") më 31 dhjetor 2016, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Ne kemi audituar:

Pasqyrat financiare të Bankës përfshijnë:

- pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave tjera përmbledhëse;
- pasqyra e pozicionit financiar;
- pasqyra e rrjedhës së parasë;
- pasqyra e ndryshimit në kapital; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë politika të rëndësishme kontabël.

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" në këtë raport.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën e opinionit tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"), të cilat janë të zbatueshme në auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Kosovës. Ne kemi përmbytur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Menaxhmenti i Bankës, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat Menaxhmenti i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Menaxhmenti i Bankës është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur Menaxhmenti synon ta likuidojë Bankën apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e Bankës janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

PricewaterhouseCoopers Kosovo, Rr. Mujo Ulqinaku, Nr. 5, Ap. 10, Qyteza Pejton, 10 000, Prishtinë, Kosovë
T: +381 (0) 38722 555/+377 (0) 45322 722, F:+381 (0)38722 276, www.pwc.com/ks

E regjistruar në Agënsionin për Regjistrim të Bizneseve në Kosovë me numer të biznesit 70609711



Raporti i audituesit të pavarur (vazhdim)

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një gabim material. Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshtëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticism të profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimit material në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga Menaxhmenti.
- japim përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga Menaxhmenti dhe bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri të materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Bankës.
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që siguron paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Bankës, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

PricewaterhouseCoopers Kosovo sh.p.k.

PricewaterhouseCoopers Kosovo sh.p.k
Prishtinë, Kosovë
12 prill 2017

	Shënime	2016	2015
Të ardhura nga interesi	7	39,116	46,083
Shpenzime e interesit	7	(1,803)	(3,124)
Të ardhurat neto nga interesi		37,313	42,959
Provizioni për zhvlerësimin e kredive të klientëve	13	(1,800)	(3,143)
Të ardhura neto nga interesi pas provizionit për zhvlerësimin e kredive		35,513	39,816
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	8	9,609	10,495
Shpenzime nga tarifat dhe komisioni	8	(4,943)	(4,025)
Fitim minus humbje nga instrumentet financiare të vlefshme për shitje		-	3
Fitime minus humbje nga kurset e këmbimit		385	515
Të ardhura të tjera operative		1,216	1,384
Shpenzime administrative dhe të tjera operative	9	(23,943)	(27,605)
Fitimi para tatimit		17,837	20,583
Shpenzimi i tatim fitimit	10	(1,778)	(2,213)
Fitimi për vitin		16,059	18,370
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:			
Zërat që mund të riklasifikohen më pas në fitim ose në humbje:			
Instrumente financiare të vlefshme për shitje:			
Fitime minus humbjet që rezultojnë gjatë vitit, neto	10	229	58
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		16,288	18,428

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 50, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

	Shënime	2016	2015
Aktivitet			
Paraja e gatshme dhe gjendjet me bankat qendrore	11	121,264	164,808
Kredi dhe paradhënie për bankat	12	67,004	81,861
Kredi dhe paradhënie për klientët	13	452,514	436,730
Aktive financiare të vlefshme për shitje	14	131,378	88,012
Aktivitet financiar të tjera	17	5,112	1,941
Tatim fitimi i parapaguar	10	2,138	330
Aktiv për tatim fitimin e shtyrë	10	-	544
Aktive të tjera	18	5,059	890
Aktivitet e patrupëzuara	15	152	580
Prona dhe pajisje	16	16,376	16,097
Totali i aktiveve		800,997	791,793
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave të tjera	19	227	249
Detyrime ndaj klientëve	20	688,843	678,057
Hua	21	10,034	8,021
Borxhi i varur	21	7,645	7,647
Detyrime për tatim fitimin e shtyrë	10	280	-
Detyrime të tjera financiare	22	1,385	1,267
Detyrime të tjera	23	1,859	2,116
Totali i detyrimeve		710,273	697,357
Kapitali			
Kapitali aksionar	24	61,346	61,346
Primi i aksioneve	24	4,204	4,204
Rezerva te kushtezuara	24	511	511
Rezerva për rivleresimin e instrumenteve financiare të vlefshme për shitje	24	223	(6)
Fitimi i akumuluar		24,440	28,381
Totali i kapitalit		90,724	94,436
Totali i detyrimeve dhe i kapitalit		800,997	791,793

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 50, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare duhet të miratohen nga Bordi drejtues, më 11 Prill 2017, dhe të nënshkruhen në emër të Bordit nga:

Ilir Aliu
Drejtor i Përgjithshëm

Rezak Fetai
Menaxher i lartë

	Shënime	2016	2015
Rrjedha e parasë nga aktivitete operative			
Fitimi para tatimit		17,837	20,583
Rregullime për:			
Zhvlerësim	16	2,374	2,080
Amortizim	15	846	864
Fitimet për çregjistrimin e pronës dhe të pajisjeve		(143)	(42)
Humbje nga rënia e vlerës së kredive	13	1,800	3,143
Të ardhura nga interesi	7	(39,116)	(46,083)
Shpenzime nga interesi	7	1,803	3,124
Rrjedha e parasë së përdorur në aktivitetet operative para ndryshimeve në aktivitet operative			
		(14,599)	(16,331)
(Rritja)/ulja neto në:			
Detyrime ndaj bankave tjera		(3,667)	20,012
Kredi dhe paradhënie për klientët		(17,997)	(25,029)
Aktive të tjera		(4,169)	(101)
Aktive financiare të tjera		(3,171)	775
Gjendjet me Bankën Qendrore		(12,932)	18,089
Rritja(ulja) neto në:			
Detyrime ndaj bankave të tjera		(22)	(33)
Detyrime ndaj klientëve		12,361	(5,692)
Detyrime të tjera		(257)	(7)
Detyrime financiare të tjera		118	473
		(44,338)	(8,790)
Interesi i arkëtuar		38,869	46,502
Interesi i paguar		(3,368)	(5,712)
Tatim fitimi i paguar		(2,766)	(3,657)
Paraja neto (e përdorur në)/ gjeneruar nga aktivitetet operative		(11,600)	28,343
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e instrumenteve financiare të vlefshme për shitje		(86,712)	(82,885)
Arkëtime nga shitja e instrumenteve financiare të vlefshme për shitje		44,262	90,180
Blerja e objekteve dhe e pajisjeve	16	(2,674)	(7,837)
Arkëtime nga shitja e objekteve dhe e pajisjeve		163	4,150
Blerja e aktiveve të patrupëzuara	15	(421)	(635)
Paraja neto (e përdorur në)/nga aktivitetet investuese		(45,382)	2,973
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financiare			
Arkëtime nga huamarrjet afatgjata		2,000	951
Dividend i paguar	24	(20,000)	(20,000)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet financiare		(18,000)	(19,049)
Rritja(ulja) neto në mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre			
		(74,982)	12,267
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit			
		221,982	209,715
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	11	147,000	221,982

Pasqyra e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 50, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

	Kapitali aksionar	Primi i aksioneve	Rezerva të kushtë- zuara	Fitimi i akumuluar	Rezerva e vlerës së drejtë	Totali
Gjendja, më 1 janar 2015	61,346	4,204	511	30,011	(64)	96,008
Fitimi i vitit	-	-	-	18,370	-	18,370
Të ardhura të tjera përmbledhëse	-	-	-	-	58	58
Totali i të ardhurave përmbledhëse	-	-	-	18,370	58	18,428
Dividendë të paguar	-	-	-	(20,000)	-	(20,000)
Bilanci, më 31 dhjetor 2015	61,346	4,204	511	28,381	(6)	94,436
Totali i të ardhurave përmbledhëse						
Fitimi i vitit	-	-	-	16,059	-	16,059
Të ardhura të tjera përmbledhëse	-	-	-	-	229	229
Totali i të ardhurave përmbledhëse	-	-	-	16,059	229	16,288
Dividendë të paguar	-	-	-	(20,000)	-	(20,000)
Gjendja, më 31 dhjetor 2016	61,346	4,204	511	24,440	223	90,724

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në faqen 50, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

1. Hyrje

Banka është e licencuar që të operojë si një bankë në të gjitha fushat bankare në Kosovë në përputhje me rregullat e Bankës Qendrore të Kosovës (ish-Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës- AQBK) dhe aktualisht i nënshtrohet Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093. Banka “ProCredit” ishte banka e parë e licencuar në Kosovë. “ProCredit Bank SH.A.” është bankë komerciale e orientuar në zhvillim, e cila ofron shërbime për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe për personat privatë. Në operacionet e saj ajo i përmbahet një sërë parimesh bazë si: e vlerëson transparencën në komunikim me klientë, synon t’i zvogëlojë dëmet ekologjike, dhe synon të sigurojë shërbime të cilat bazohen në kuptimin e gjendjes së secilit klient dhe në analizën financiare.

Selia dhe vendi i biznesit

Selia e bankës është e vendosur në rrugën “Xhorxh Bush”, Nr. 26, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës. Gjatë vitit 2016 banka operoi me degë, qendra shërbimi, pika shërbimi dhe zona 24/7 (vetëshërbimi) në mënyrë që t’u ofrojë klientëve shërbime më të arritshme dhe më gjithëpërfshirëse.

Bordi i drejtorëve:

- Z. Borislav Kostadinov, kryesues
- Znj. Helen Alexander, anëtare
- Z. Rainer Ottenstein, anëtar
- Z. Jordan Damchevski, anëtar
- Z. Luan Gashi, anëtar
- Z. Ilir Aliu, anëtar dhe drejtor i përgjithshëm

i bankës

2. Politikat e rëndësishme kontabël

(a) Baza e përgatitjes

Deklarata e pajtueshmërisë. Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) sipas analizës historike të kostove, të modifikuar me rivlerësimin e aktiveve financiare të vlefshme për shitje. Politikat kryesore kontabël, të zbatuara në përgatitjen e pasqyrave financiare, janë renditur më poshtë. Këto politika janë përdorur vazhdimisht për të gjitha periudhat e paraqitura, përveç nëse ceket ndryshe.

Përdorimi i gjykimeve dhe i vlerësimeve

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare drejtimi ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të bankës dhe mbi shumat e raportuara të aktiveve, të detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive. Informacionet mbi elementët e rëndësishëm me pasiguri në vlerësime dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël me efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimet 4, 5 dhe 6.

Valuta funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare paraqiten në euro, e cila paraqet valutën funksionale të bankës, valutë kjo e mjedisit ekonomik në të cilën subjekti operon. Të gjitha shumat janë rumbullakuara në mijëshen më të afërt, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

(b) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që zbrit pagesat dhe arkëtimet e ardhshme përgjatë jetës së pritshme të aktivitetit financiar ose pasivitetit financiar (ose kur është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër) deri në vlerën kontabël të aktivitetit financiar ose të pasivitetit financiar. Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, banka vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme të kredisë.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha kostot e transaksionit dhe komisionet e zbritjet e tjera të paguara ose të pranuar, të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që janë direkt të lidhura me blerjen apo emetimin e një aktiviteti apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose të humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse përfshijnë:

- Interesa nga aktive ose detyrime financiare, matur me koston e amortizuar të llogaritur mbi bazën e interesit efektiv; dhe
- Interesa nga investime të vlefshme për shitje të llogaritura mbi bazën e interesit efektiv.

(c) Tarifa dhe komisione

Tarifat të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit përfshijnë tarifat e nisjes të arkëtuara ose të paguara nga subjekti, lidhur me krijimin ose blerjen e aktiveve financiare ose lëshimin e detyrimeve financiare, për shembull, tarifat për vlerësimin e aftësisë për kthimin e kredisë, vlerësimin dhe regjistrimin e garancive ose kolateralit, negocimin e kushteve të instrumenteve dhe tarifat për përpunimin e dokumentacionit të transaksionit. Tarifat e zotimit, të arkëtuara nga banka për të nisur kredi me normat e interesit të tregut, janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit nëse ka gjasa që banka të hyjë në një marrëveshje specifike për kredidhënie dhe nuk pret ta shesë kredinë rezultuese menjëherë pas nisjes së saj.

Kur kthimi i kredive dhe i instrumenteve të tjera të borxhit vihet në dyshim, ato shkruhen me vlerën aktuale të rrjedhës hyrëse të pritur të parave dhe më pas të ardhurat nga interesi regjistrohen për vlerën kohore të zbritjes së vlerës aktuale, duke u bazuar në normën efektive të interesit të aktivitetit, e cila është përdorur për ta matur humbjen nga zhvlerësimi.

Të gjitha tarifat e tjera, komisionet dhe zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të tjera përgjithësisht regjistrohen në bazë të parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke iu referuar përfundimit të transaksionit specifik mbi bazën e shërbimeve reale të kryera si përqindje e shërbimeve të përgjithshme, të cilat do të ofrohen.

(d) Qiratë operative

Pagesat e kryera për qiratë operative njihen në pasqyrën e fitimit/humbjeve sipas metodës lineare përgjatë afatit të qirasë. Zbritja nga qiraja njihet si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimeve për qira, përgjatë afatit të qirasë.

(e) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valuta të huaja janë kthyer në valutën funksionale, duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në valutë të huaj rivlerësohen në valutën funksionale të bankës me kursin në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në valutën funksionale në fillim të periudhës, të rregul-

luara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në valutë të huaj të kthyer në valutë funksionale me kursin e fundvitit. Diferencat nga kursi i këmbimit, të cilat rrjedhin nga rivlerësimi në valutën funksionale, njihen në fitim ose në humbje.

(f) Tatimi në fitim

Tatimet në fitim janë paraqitur në pasqyra financiare në përputhje me legjislacionin e miratuar, si dhe me legjislacionin e hyrë në fuqi deri në fund të periudhës raportuese.

Ngarkesa e tatimit në fitim përbëhet nga tatimi aktual dhe tatimi në fitim i shtyrë dhe njihet në pasqyrën e fitimit dhe të humbjes së vitit, përveç nëse njihet në të ardhurat tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejt në kapital, pasi që ndërlihet me transaksionet të cilat gjithashtu njihen në periudhën e njëjtë ose në periudhë tjetër, në të ardhura të tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejt në kapital.

(I) Tatimi aktual

Tatimi aktual është shuma e pagueshme ose e arkëtueshme nga autoritetet tatimore në lidhje me fitimet ose humbjet e tatueshme për periudhat aktuale dhe paraprake. Fitimet dhe humbjet e tatueshme bazohen në vlerësime nëse pasqyrat financiare autorizohen para dorëzimit të kërkesave relevante për rimbursim të tatimit. Tatimet tjera të ndryshme nga tatimi në fitim regjistrohen në kuadër të shpenzimeve administrative dhe operative.

(II) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë në të ardhura llogaritet duke përdorur metodën e detyrimit të bilancit të gjendjes për bartjet e humbjeve nga tatimi dhe diferencat e përkohshme që dalin nga baza e tatimeve të aktiveve dhe detyrimeve dhe shumat e tyre bartëse për qëllime të raportimit financiar.

Gjendja e tatimit të shtyrë matet me normat tatimore në fuqi ose të hyra në fuqi në fund të periudhës raportuese, të cilat pritet të aplikohen për periudhën kur diferencat e përkohshme të kthehen ose kur bartjet e humbjeve nga tatimi të përdoren.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme dhe bartjet e humbjeve nga tatimi regjistrohen deri në masën që është e mundur për të pasur të ardhura të tatueshme kundrejt të

cilave ky aktiv tatimor pritet të përdoret.

(III) Pozicionet tatimore të pasigurta

Pozicionet tatimore të pasigurta të bankës rivlerësohen nga menaxhmenti në fund të secilës periudhë raportuese. Detyrimet regjistrohen për pozicionet tatimore të pasigurta, të cilat përcaktohen nga menaxhmenti si të tilla që ka më shumë gjasa se nuk do të rezultojnë me taksa shtesë të vëna nëse ato pozicione do të kontestoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore të cilat janë në fuqi, ose që kanë hyrë në fuqi deri në fund të periudhës raportuese dhe çdo aktvendimi gjyqësor të njohur ose të ndonjë organi tjetër lidhur me çështje të tilla. Detyrimet për gjoba, interes dhe tatime të ndryshme nga ato në fitim njihen në bazë të vlerësimeve më të mira të shpenzimeve të bëra nga menaxhmenti që kërkohen për shlyerjen e detyrimeve në fund të periudhës raportuese.

(g) Instrumentet financiare

(I) Njohja

Banka fillimisht njeh kreditë dhe paradhëniet, depozitat dhe borxhin e varur në datën që ato janë emetuar. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare (duke përfshirë dhe blerjet e shitjet e rregullta të aktiveve financiare) njihen fillimisht në datën e tregtimit, e cila është data kur banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv ose detyrim financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen apo lëshimin e tij.

(II) Klasifikimi

Aktivet financiare

Banka klasifikon aktivet e saj financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- Hua dhe llogari të arkëtueshme; dhe
- Të vlefshme për shitje.

Shiko pikat (h), (l) dhe (j).

Detyrimet financiare

Banka i klasifikon detyrimet e saj financiare, përveç garancive financiare dhe zotimeve për kredi, si të matura me kosto të amortizuar [shënimi 2(p)].

2.Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Instrumentet financiare (vazhdim)

(III) Çregjistrimi

Banka çregjistron një aktiv financiar kur të mbarojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar ose ajo transferon të drejtat për të marrë flukse mjeteve monetare kontraktuale në një transaksion, në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar janë transferuar ose në të cilat banka as nuk transferon e as nuk ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e aktivit financiar.

Në momentin e çregjistrimit të një aktivit financiar diferenca midis vlerës kontabël neto të aktivit (ose vlera kontabël që i përket pjesës së aktivit të transferuar) dhe totalit të (I) konsideratës së marrë (duke përfshirë çdo aktiv të ri të përftuar ose detyrim të supozuar) dhe (II) çdo fitimi ose humbje kumulative që është njohur në të ardhura të tjera përmbledhëse. Interesat që mbahen ose krijohen nga banka mbi aktivet e transferuara, të cilat kualifikohen për t'u çregjistruar, njihen si një aktiv apo detyrim i veçantë. Banka çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, janë ndërprerë apo kanë përfunduar.

(IV) Kompensimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur banka ka të drejtën ligjore për t'i kompensuar shumat dhe ajo synon ose t'i shlyejë ato në një bazë neto, ose ta realizojë aktivin dhe ta shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF-së.

(V) Matja me kosto të amortizuar

Kostoja e amortizuar është vlera me të cilën instrumenti financiar matet në njohjen fillestare, minus shlyerjet e kryeqjësë, plus interesi i akumuluar, dhe për aktivet financiare, minus zhvlerësimi për humbjet nga rënia e vlerës. Interesi i akumuluar përfshin amortizimin e kostos së shtyrë të transaksionit në njohjen fillestare dhe çdo premi ose zbritje për shumën e maturimit, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat e interesit të akumuluar dhe shpenzimet e interesit të akumuluar, duke përfshirë edhe kuponët e akumuluar dhe zbritjen e amortizuar ose primet (duke përfshirë tarifrat e

shtyra fillestare, nëse ka) nuk paraqiten të ndara dhe përfshihen në vlerat e bartura të zërave përkatës në pasqyrën e pozicionit financiar.

Metoda e interesit efektiv: Është një metodë e ndarjes së të ardhurave nga interesi apo i shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës përkatëse, në mënyrë që të arrihet një normë e vazhdueshme periodeke e interesit (norma efektive e interesit) mbi vlerën kontabël. Norma efektive e interesit është norma që saktësisht zbrët pagesat e ardhshme ose faturat (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kredisë) nëpërmjet jetës së pritshme të instrumentit financiar ose një periudhe më të shkurtër, nëse është e përshtatshme, në vlerën kontabël neto të instrumentit financiar.

(VI) Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është çmimi me të cilin aktivi mund të shitet ose të transferohet në një transaksion të zakonshëm mes pjesëmarrësve në treg në datën e matjes. Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë është çmimi në një treg aktiv. Treg aktiv është ai ku transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me shpeshtësi dhe volum të mjaftueshëm për të siguruar informata të çmimeve në mënyrë të vazhdueshme.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare, që tregtohen në një treg aktiv, matet si produkt i çmimit të kuotuar për aktivin ose detyrimin individual dhe për sasinë e mbajtur nga subjekti.

Derivatvët financiarë ose aktivet dhe detyrimet e tjera financiare që nuk janë tregtuar në një treg aktiv maten me vlerën e drejtë të një grupi të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare mbi bazën e çmimit që do të pranohej për të shitur një pozicion të gjatë neto (p.sh. një aktiv) për një ekspozim të veçantë të rrezikut ose paguhej për të transferuar një pozicion të shkurtër neto (p.sh. një detyrim) për një ekspozim të veçantë të rrezikut në një transaksion të zakonshëm midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes.

Kjo është e zbatueshme për aktivet e bartura me vlerën e drejtë mbi bazën e përsëritjes nëse banka: (a) menaxhon grupin e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare mbi bazën e ekspozimit neto të njësisë ndaj një rreziku të caktuar (ose rreziqeve) të tregut ose ndaj rrezikut kreditor të një pale tjetër të veçantë në përputhje me menaxhimin e dokumen-

tuar të rrezikut nga ana e subjektit ose me strategjinë e investimeve; (b) jep informata mbi atë bazë për grupin e aktiveve dhe detyrimeve të personelit menaxhues kryesor të subjektit; dhe (c) rreziqet e tregut, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e ekspozimit të subjektit ndaj një rreziku (rreziqeve) të veçantë të tregut që dalin nga aktivet dhe detyrimet financiare janë në thelb të njëjta.

Teknikat e vlerësimit, të tilla si modelet e zbritura të flukseve të parave apo modelet e bazuara në parimin “transaksione sipas parimit të tregut” ose shqyrtimi i të dhënave financiare të subjekteve në të cilat është investuar, përdoren për të matur vlerën e drejtë të instrumenteve financiare të caktuara për të cilat informatat e jashtme për çmimet e tregut nuk janë në dispozicion.

Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë si në vijim:

(I) niveli i parë janë matjet në çmimet e kuotuar (të parregulluara) në tregje aktive për aktive ose detyrime identike; (II) matjet e nivelit të dytë janë teknikat e vlerësimit me të gjitha inputet materiale të vëzhgueshme për aktivin ose detyrimin, qoftë drejtpërdrejt (d.m.th., si çmime) ose tërthorazi (d.m.th., që rrjedhin nga çmimet); dhe (III) matjet e nivelit të tretë janë vlerësimet që nuk bazohen vetëm të dhëna të vëzhgueshme të tregut (d.m.th., matja kërkon inpute të konsiderueshme të pavëzhgueshme).

(VII) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Zhvlerësimi i kredive dhe i paradhënieve

Në çdo datë raportimi banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare, të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, janë zhvlerësuar. Një aktiv financiar ose një grup aktivesh financiare është zhvlerësuar kur evidencat objektive demonstrojnë se një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit (ngjarje e humbjes) dhe që ngjarja (ose ngjarjet) e cila sjell humbje ka një ndikim në flukset e ardhshme monetare të aktivitetit ose grupeve të aktiveve dhe që mund të vlerësohet me besueshmëri. Kriteret e përdorura nga banka për të vendosur nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuar mund të përfshijnë:

- Mospagim i detyrimeve kontraktuale të kryegjësë ose interesit;
- Vështirësi në flukset e monetare të përjetuara nga kredimarrësi (si për shembull, raporti i kapitalit,

përçindjet e të ardhurave neto mbi shitjet);

- Shkelja e kontratave ose e kushteve të kredisë;
- Fillimi i procedurave të falimentimit;
- Përkeqësimi i pozicionit konkurrues të kredimarrësit;
- Përkeqësimi i vlerës së kolateralit.

Periodha e vlerësuar ndërmjet humbjes që ndodh dhe identifikimit të saj përcaktohet nga menaxhmenti lokal për secilin portofol të identifikuar. Në përgjithësi, periudhat e përdorura variojnë midis 3 dhe 12 muajve, në rastet e veçanta përdoren periudha më të gjata.

Banka fillimisht konsideron nëse ka dëshmi objektive për zhvlerësimin individual të aktiveve financiare që janë individualisht të rëndësishme, si dhe zhvlerësim individual ose kolektiv për aktivet financiare që nuk janë individualisht të rëndësishëm. Nëse banka përcakton se nuk ka dëshmi objektive zhvlerësimi për një aktiv financiar të vlerësuar individualisht, qoftë i rëndësishëm ose jo, ajo e përfshin aktivin në një grup aktivesh financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë dhe e vlerëson në mënyrë kolektive zhvlerësimin e tyre. Aktivet që janë vlerësuar individualisht për zhvlerësimin dhe për të cilat një humbje nga zhvlerësimi është njohur apo vazhdon të njihet, nuk janë të përfshira në një vlerësim kolektiv të zhvlerësimit.

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të matura me kosto të amortizuar llogariten si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme (duke përjashtuar humbjet kreditore që nuk janë pësuar), të zbritur me normën filltare efektive të interesit të aktivitetit. Vlera kontabël e aktivitetit ulet nëpërmjet përdorimit të një llogarie zbritjeje dhe shuma e humbjes njihet në fitimin ose humbjen e vitit.

Llogaritja e vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të mjeteve monetare të një aktiviteti financiar të vendosur si kolateral pasqyron flukset monetare që mund të rezultojnë nga ekzekutimi minus kostot për përfitimin dhe shitjen e kolateralit, nëse konfiskimi është i mundshëm.

Për qëllimet e një vlerësimi kolektiv të zhvlerësimit aktivitetet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kredisë (në bazë të procesit të vlerësimit të bankës që konsideron

llojin e aktivitetit, të industrisë, lokacionin gjeografik, llojin e kolateralit, statusin e detyrimit të kaluar dhe faktorët e tjerë relevantë). Këto karakteristika janë relevante për përlllogaritjen e flukseve të mjeteve monetare për grupet e aktiveve të tilla duke qenë tregues për aftësinë e debitorëve për t'i paguar të gjitha shumat në mënyrë të duhur sipas kushteve kontraktuale të aktiveve që vlerësohen.

Të gjitha kreditë me shumë të mbetur prej 30 mijë eurosh ose më shumë vlerësohen individualisht, ndërsa kreditë nën këtë nivel janë konsideruar si jo të mëdha dhe vlerësohen në një bazë kolektive duke treguar indikacione të ngjarjeve të humbjeve. Për kreditë e zhvlerësuar jo të mëdha llogariten nivelet e mëposhtme, duke u bazuar në përvojën historike të bankës në mjedis të ngjashme ekonomike.

(VII) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

	Niveli i lejimit 2016	Niveli i lejimit 2015
Vonesa 0 – 30 ditë	2.05%	1.99%
Vonesa 31 – 90 ditë	55%	55%
Vonesa > 91 ditë	80%	75%
Vonesa > 180 ditë	90%	90%

Flukset e ardhshme të mjeteve monetare nga një grup aktivesh financiare, të cilat janë vlerësuar në baza kolektive për zhvlerësim, përlllogariten në baza të rrjedhave kontraktuale të parave të gatshme të aktiveve në bankë dhe përvojës historike të humbjes për aktivitetet me karakteristika të rrezikut kreditor të ngjashme me ato në bankë. Përvoja e humbjes historike përshtatet në bazë të të dhënave të tanishme të vëzhgueshme për t'i reflektuar efektet e kushteve të tanishme, të cilat nuk kanë ndikuar në periudhën në të cilën bazohet përvoja e humbjes historike dhe për t'i larguar efektet e kushteve në periudhën historike, e cila nuk ekziston aktualisht. Përlllogaritjet e ndryshimeve në flukset e ardhshme të mjeteve monetare për grupet e aktiveve duhet të reflektojnë dhe të jenë në përputhje të drejtpërdrejtë me ndryshime në të dhënat përkatëse të vëzhgueshme nga periudha në periudhë (për shembull, ndryshime në normat e papunësisë, çmimet e pronave, statusi i pagesës ose faktorët e tjerë indikativë për ndryshimet në probabilitetin e humbjeve në bankë dhe në shtrirjen e tyre). Metodologjia dhe supozimet e përdorura në llogaritjen e flukseve të ardhshme monetare rishikohen rregullisht nga banka për të reduktuar ndonjë dal-

lim ndërmjet llogaritjeve të humbjes dhe përvojës aktuale të humbjes.

Në rastet kur një kredi nuk mund të mbliidhet, ajo shlyhet kundrejt provizionit përkatës për zhvlerësimin e kredisë. Kreditë e tilla janë shlyer pasi të jenë kompletuar të gjitha procedurat e nevojshme dhe pasi të jenë përcaktuar shumat e humbjes.

Nëse, gjatë një periudhe pas datës së raportimit, shumat e humbjes nga zhvlerësimi ulet dhe ulja mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje që ndodh pas regjistrimit të zhvlerësimit (p.sh. një përmirësim në kategorizimin kreditor të debitorit) bëhet kthimi i humbjes nga zhvlerësimi i regjistruar më parë, duke rregulluar shumën e lejimit. Kjo shumë njihet në fitim-humbje ose humbje nga rënia e vlerës së kredive.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare të vlefshme për shitje

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje për vitin kur ndodhin si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve ("Ngjarja e humbjes") që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të letrave me vlerë investive të vlefshme për shitje. Rënia domethënëse ose e zgjatur e vlerës së drejtë të një investimi nën koston e tij është tregues se është zhvlerësuar. Humbja kumulative e zhvlerësimit - e matur si diferencë ndërmjet koston së blerjes dhe vlerës së drejtë aktuale, minus çdo humbje nga rënia në vlerë e atij aktivi që më parë njihet në fitim ose humbje – riklasifikohet nga të ardhurat e tjera përmbledhëse në fitim ose humbje për atë vit. Humbjet e zhvlerësimit të instrumenteve kapitali nuk kthehen dhe çfarëdo fitimi pasues njihet në të ardhura të tjera përmbledhëse. Nëse, në një periudhë pas datës së raportimit, vlera e drejtë e instrumentit të borxhit i klasifikuar si i vlefshëm për shitje rritet dhe rritja mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje që ndodh pasi humbja nga zhvlerësimi është regjistruar në fitim-humbje, humbja nga zhvlerësimi kthehet përmes fitimit dhe humbjes.

(h) Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë monedha dhe kartëmonedha në arkë, balanca në Bankën Qendrore të pakufizuara në përdorim dhe aktive financiare shumëlikuide me maturim fillestar deri në tre muaj, të cilat kanë rrezik të pakonsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejtë dhe përdoren nga banka për manaxhimin e zotimeve afatshkur-

tra. Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen me kosto të amortizuara në pasqyrën e pozicionit financiar.

(i) Kreditë dhe paradhëniet

Kreditë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe banka nuk ka për qëllim t'i shesë menjëherë apo në një periudhë afatshkurtër. Kreditë dhe paradhëniet për bankat dhe për klientët klasifikohen si hua dhe llogari të arkëtueshme. Kreditë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit dhe në vijim maten me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(j) Aktivet financiare të vlefshme për shitje

Ky klasifikim përfshin letrat me vlerë të investimit që banka ka ndërmend t'i mbajë për një periudhë të pacaktuar kohore dhe që mund të shiten si përgjigje ndaj nevojave për likuiditet apo ndryshime në normat e interesit, kurset e këmbimit apo çmimet e ekuitetit.

Letrat me vlerë të investimit të vlefshëm për shitje fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot e drejtpërdrejta rritëse të transaksionit dhe të bartura më pas me vlerën e drejtë.

Të ardhurat nga interesi i letrave me vlerë të borxhit llogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe njihen në fitim ose në humbje të vitit.

Të ardhurat nga dividendi njihen në fitim ose në humbje kur banka fiton të drejtën në dividendë. Të gjitha elementet e tjera të ndryshimeve në vlerën e drejtë njihen në të ardhurat tjera përmbledhëse derisa investimi të çregjistrohet ose të zhvlerësohet, me ç'rast fitimi ose humbja kumulative riklasifikohet nga të ardhurat tjera përmbledhëse në fitim ose në humbje të vitit. Dividendët njihen në fitim ose në humbje kur banka fiton të drejtën për ta përfituar këtë dividend.

(k) Prona dhe pajisje

Prona dhe pajisjet shprehen në kosto historike minus zhvlerësimi i akumuluar dhe rënia e vlerës së akumuluar, nëse ka. Kostoja historike përfshin shpenzimet që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes së pronës dhe të pajisjeve...

Shpenzimet e mëpasshme njihen vetëm nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike të cilat u

atribuohen atyre do të rrjedhin te banka në të ardhmen, si dhe kostoja e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme. Të gjitha kostot e tjera për riparime dhe për mirëmbajtje i ngarkohen shpenzimeve operative të periudhës në të cilën kryhen.

Vlera kontabël e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara rishikohet për të përcaktuar zhvlerësimin kur ka ndryshime në ngjarjet, të cilat tregojnë se vlera e mbartur nuk mund të rikuperohet. Nëse ka të dhëna të tilla dhe vlera kontabël është më e madhe se vlera që pritët të rikuperohet, aktivet ose njësitë gjeneruese të mjeteve monetare zhvlerësohen në vlerën e tyre të rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara është vlera më madhe mes vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së përdorimit. Për të përcaktuar vlerën e përdorimit flukset e pritshme të mjeteve monetare zbriten në vlerën e tyre aktuale, duke përdorur një normë zbritjeje para tatimit, e cila reflekton një vlerësim aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun që lidhet me këtë lloj aktivi.

Për një aktiv që nuk gjeneron flukse monetare të pavarura në masë të madhe, shumën e rikuperueshme përcaktohet për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare së cilës i përkasin aktivet. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e fitimit dhe të humbjes.

Toka nuk zhvlerësohet. Zhvlerësimi i aktiveve ngarkohet në baza lineare në norma të përshkruara për alokimin e kostos së pronës dhe të pajisjeve përgjatë jetës së tyre të përlogaritur të dobishmërisë. Normat vjetore të zhvlerësimit përcaktohen nga jeta e përlogaritur e dobishmërisë së aktiveve të caktuara sipas tabelës në vijim:

Përshkrimi	Jeta e dobishme 2016	Jeta e dobishme 2015
Ndërtesat	20 vjet	20 vjet
Përmirësimet e pronës së dhënë me qira	Duke u bazuar në kushtet e qirasë	Duke u bazuar në kushtet e qirasë
Pajisjet elektronike	2-5 vite	2-5 vite
Mobilie dhe pajisje zyre	2-10 vjet	2-10 vjet
Makina motorike	3-5 vjet	3-5 vjet
Tjera aktive fikse	2-7 vjet	2-7 vjet

Pronat dhe pajisjet me jetë të dobishme më të gjatë se një vit, të cilat bien nën pragun e materialitetit prej 50 eurosh (2015: 50 euro) dhe që nuk janë materiale në total, përfshihen në fitim ose në humbje. Fitimet ose humbjet me shitjen e aktivit vendosen duke krahasuar çmimin me vlerën e mbetur. Këto janë përfshirë në të ardhura dhe shpenzime të tjera operative (sipas rastit) në fitim ose në humbje.

(l) Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara

Aktivët e qëndrueshme të patrupëzuara regjistrohen nëse është e provueshme se të mirat e ardhshme ekonomike, të cilat vijnë prej këtij aktivi, do të përfitohen nga banka dhe kostoja e aktivit mund të matet në mënyrë të besueshme. Aktivët e qëndrueshme të patrupëzuara janë matur fillimisht me kosto. Vlerat e mbartura të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara janë rishikuar për zhvlerësim kur ka ngjarje ose ndryshime në rrethana, të cilat tregojnë se vlerat e mbartura mund të mos jenë të rikuperueshme. Aktivët e qëndrueshme të patrupëzuara janë tërësisht të përbëra nga softueri (programi) kompjuterik, të cilat amortizohen duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës së dobishme prej pesë vjetësh.

(m) Depozitat dhe detyrimet e varura

Depozitat dhe detyrimet e varura janë burimet kryesore të bankës për financim.

Kur banka shet një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta riblerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në një datë të ardhshme (repo), marrëveshja kontabilizohet si një detyrim financiar dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të bankës.

Depozitat dhe detyrimet e varura maten me vlerën e drejtë minus kostot direkte të transaksionit dhe më pas maten me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv

(n) Provizione

Një provizion njihet kur si rezultat i një ngjarjeje të shkuar banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv të tanishëm, që mund të matet me besueshmëri dhe është e mundur që flukse të mirash ekonomike mund të kërkohen për ta shlyer detyrimin. Provizionet vendosen duke zbritur flukset e pritshme në të ardhmen me një normë përpara tatimit, që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Vlera kohore e zbritjes njihet si kosto financiare.

(o) Përfitimet e punonjësve

Banka paguan vetëm kontributet e detyrueshme

për planin e pensioneve të administruar në mënyrë publike. Banka nuk ka detyrime të tjera pas pagesës së këtyre kontributeve. Kontributet janë regjistruar si shpenzime të përfitimeve për punonjësit në momentin e duhur. Banka ka llogaritur dhe ka bërë provizione për pushimet e pashfrytëzuara të punonjësve deri në fund të vitit.

(p) Garancitë financiare dhe zotimet për kredi

Garancitë financiare janë kontrata që e detyrojnë bankën të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës. Zotimet për hua janë zotimet e përcaktuara për të siguruar kredi sipas termave dhe kushteve të parapërcaktuara. Zotimet e tilla financiare regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar, nëse dhe kur ato bëhen të pagueshme.

(q) Kapitali aksionar

(I) Kostoja e emetimit të aksioneve

Kostot inkrementale, që i atribuohen direkt emetimit të aksioneve të reja, janë shfaqur në kapital neto nga tatimi, nga të ardhurat.

(II) Primi i lidhur me aksionin

Primi i lidhur me aksionin paraqet vlerën e kontributeve të pranuar në tejkallim të vlerës nominale të aksioneve të emetuara.

(III) Dividendët mbi aksionet e zakonshme

Dividendët mbi aksionet e zakonshme janë regjistruar në kapital në periudhën në të cilën ato janë të aprovuara nga aksionarët e bankës. Dividendët për vitin që janë deklaruar pas datës së raportimit janë shpalosur në ngjarjet e ndodhura pas datës së raportimit.

3. Standardet e reja, ndryshimet dhe interpretimet ende të pamiratuara

Miratimi i standardeve dhe i interpretimeve të reja ose të rishikuara

Standardet e mëposhtme të ndryshuara kanë hyrë në fuqi nga 1 janari i 2016-s, por nuk kanë pasur ndonjë ndikim material për bankën.

- SNRF 14, Llogaritë Rregulluese Shtyrëse (publikuar në janar të 2014-s dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016. SNRF 14 nuk është relevant për operacionet e bankës.
- Kontabiliteti për blerjet e interesave në operacione të përbashkëta - Ndryshimet në SNRF 11 (publikuar më 6 maj 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016). Transaksionet e tilla nuk janë të rëndësishme për bankën.

likuar më 6 maj 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016). Transaksionet e tilla nuk janë të rëndësishme për bankën.

- Sqarimi i metodave të pranueshme të zhvlerësimit dhe amortizimit - Ndryshime në SNK 16 dhe SNK 38 (publikuar më 12 maj 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016). Ndryshimet nuk kanë ndikuar në pasqyrat financiare të bankës.

- Bujqësi: Bimët frutdhënëse - Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 41 (publikuar më 30 qershor 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016). Lënda nuk është relevante për operacionet e bankës.

- Metoda e kapitalit neto në pasqyrat financiare të veçanta - Ndryshimet në SNK 27 (publikuar më 12 gusht 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016). Standardi nuk është relevant për bankën.

- Përmirësimet vjetore në SNRF-të e vitit 2014 (publikuar më 25 shtator 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016). Asnjë nga përmirësimet nuk ishin relevante për operacionet e bankës.

- Ndryshimet e Iniciativës së Shpalosjes në SNK 1 (publikuar në dhjetor të 2014-s dhe në fuqi për periudhat vjetore më ose pas 1 janarit të 2016-s). Koncepti i materialitetit i futur me ndryshimet dhe udhëzimet për nëntotale nuk ndikoi në pasqyrat financiare të bankës.

- Subjektet Investuese: Zbatimi i Amendamentit për Konsolidim me Përrjashtim në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 (publikuar në dhjetor të 2014-s dhe në fuqi për periudhat vjetore më ose pas 1 janarit të 2016-s). Lënda e standardeve nuk është relevante për operacionet e bankës.

3. Standardet e reja, ndryshimet dhe interpretimet ende të pamiratuara

Miratimi i standardeve dhe i interpretimeve të reja ose të rishikuara

- SNRF 14, Llogaritë Rregulluese Shtyrëse (publikuar në janar të 2014-s dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016. SNRF 14 nuk është relevant për operacionet e bankës.

- Kontabiliteti për blerjet e interesave në operacione të përbashkëta - Ndryshimet në SNRF 11 (publikuar më 6 maj 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016). Transaksionet e tilla nuk janë të rëndësishme për bankën.

- Sqarimi i metodave të pranueshme të zhvlerësimit

it dhe amortizimit - Ndryshime në SNK 16 dhe SNK 38 (publikuar më 12 maj 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016). Ndryshimet nuk kanë ndikuar në pasqyrat financiare të bankës.

- Bujqësi: Bimët frutdhënëse - Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 41 (publikuar më 30 qershor 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016). Lënda nuk është relevante për operacionet e bankës.

- Metoda e kapitalit neto në pasqyrat financiare të veçanta - Ndryshimet në SNK 27 (publikuar më 12 gusht 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016). Standardi nuk është relevant për bankën.

- Përmirësimet vjetore në SNRF-të e vitit 2014 (publikuar më 25 shtator 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016). Asnjë nga përmirësimet nuk ishin relevante për operacionet e bankës.

- Ndryshimet e Iniciativës së Shpalosjes në SNK 1 (publikuar në dhjetor të 2014-s dhe në fuqi për periudhat vjetore më ose pas 1 janarit të 2016-s). Koncepti i materialitetit i futur me ndryshimet dhe udhëzimet për nëntotale nuk ndikoi në pasqyrat financiare të bankës.

- Subjektet Investuese: Zbatimi i Amendamentit për Konsolidim me Përrjashtim në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 (publikuar në dhjetor të 2014-s dhe në fuqi për periudhat vjetore më ose pas 1 janarit të 2016-s). Lënda e standardeve nuk është relevante për operacionet e bankës.

Deklaratat e reja të kontabilitetit

Standarde dhe interpretime të caktuara të reja janë publikuar e të cilat janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit të 2017-s ose më vonë dhe të cilat banka nuk i ka miratuar më herët.

SNRF 9 “Instrumentet Financiare: Klasifikimi dhe Matja” (ndryshuar në korrik të 2014-s dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit të 2018-s). Karakteristikat kryesore të standardit të ri janë:

- Aktivitetet financiare janë të nevojshme të klasifikohen në tri kategori të matjes: ato që maten më pas me koston e amortizuar, ato që do të maten me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse (VDATP) dhe të atyre që do të maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDFH).

- Klasifikimi për instrumentet e borxhit është i shtyrë nga modeli i biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e aktiveve financiare dhe nëse flukset monetare kontraktuale përfaqësojnë vetëm pagesa të kryegjësë dhe të interesit (VPKI). Nëse një instrument borxhi është mbajtur për të mbledhur, ai mund të bartet me koston e amortizuar nëse ajo gjithashtu plotëson kërkesat VPKI. Instrumentet e borxhit që plotësojnë kërkesat VPKI, të cilat janë mbajtur në një portofol, ku një njësi ekonomike edhe mban aktivet për t'i mbledhur flukset monetare dhe shet aktivet mund të klasifikohen si VDATP. Aktivitetet financiare që nuk përmbajnë flukse monetare të cilat janë VPKI duhet të maten me VDFH (për shembull, derivativët). Derivativët e përfshirë nuk janë më të ndara nga aktivet financiare, por do të përfshihen në vlerësimin e gjendjes VPKI.

- Investimet në instrumente të kapitalit neto maten gjithmonë me vlerën e drejtë. Megjithatë, menaxhmenti mund të bëjë një zgjedhje të pakthyeshme për t'i paraqitur ndryshimet në vlerën e drejtë në të ardhura të tjera përmbledhëse, me kusht që instrumenti nuk është mbajtur për tregtim. Nëse instrumenti i kapitalit neto është i mbajtur për tregtim, ndryshimet në vlerën e drejtë paraqiten në fitim ose në humbje.

3. Standardet e reja, ndryshimet dhe interpretimet ende të pamiratuara (vazhdim)

Deklaratat e reja të kontabilitetit (vazhdim)

- Shumica e kërkesave në SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare janë bartur pa ndryshuar te SNRF 9-shi. Ndryshimi kryesor është që një njësi ekonomike do të kërkohet t'i paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun e tyre të kreditit të detyrimeve financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në kapitalin neto në të ardhura të tjera përmbledhëse.

- SNRF 9-shi paraqet një model të ri për njohjen e humbjeve nga zhvlerësimi – modeli i humbjeve të pritshme të kreditit (HPK). Ka një qasje me “tri faza”, e cila është e bazuar në ndryshimin në cilësinë e kredisë së aktiveve financiare që prej njohjes fillestare. Në praktikë, rregullat e reja nënkuptojnë se subjektet do të duhen për t'i regjistruar në një humbje të menjëhershme të barabartë me HPK 12-mujore në njohjen fillestare të aktiveve financiare që nuk janë të dëmtuara për kredit (ose kohëzgj-

jatjen e HPK-së për mjete të arkëtueshme tregtare). Ku ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë zhvlerësimi matet duke përdorur kohëzgjatjen e HPK-së në vend të HPK-së 12-mujore. Modeli përfshin thjeshtësimet operative për qira dhe mjete të arkëtueshme tregtare.

- Kërkesat e kontabilitetit mbrojtës janë ndryshuar për të lidhur kontabilitetin më ngushtë me menaxhimin e rrezikut. Standardi u jep subjekteve një zgjedhje të politikës kontabël në mes të zbatimit të kërkesave të kontabilitetit mbrojtës të SNRF 9-shit dhe vazhdimin të zbatimit të SNK 39-shit për të gjitha mbrojtjet sepse standardi aktualisht nuk adreson kontabilitetin për makro-mbrojtje.

SNRF 9 “Instrumentet financiare” do të kenë një ndikim në njohjen, matjen, dëmtimin, si dhe në kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të instrumenteve financiare. Banka nuk pret që kërkesat e reja të klasifikimit do të kenë një ndikim material. Duke u bazuar në vlerësimin paraprak, zbatimi i kërkesave të SNRF 9-shit për zhvlerësim pritet të rezultojë në një rritje në lejim të humbjes në momentin e transicionit dhe të moderojë rritjen e shpenzimeve për lejimin për humbjet nga kreditë dhe paradhëniet. Kërkesat e reja të kontabilitetit mbrojtës nuk do të ndikojnë në pasqyrat financiare pasi banka nuk zbaton kontabilitetin mbrojtës. SNRF 9-shi zbatohet për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit të 2018-s.

SNRF 15, Të ardhurat nga kontratat me klientët (publikuar më 28 maj 2014 dhe në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018). Standardi i ri paraqet parimin bazë se të ardhurat duhet të njihen kur mallrat ose shërbimet janë transferuar te konsumatori me çmimin e transaksionit. Çdo mall tubë ose shërbimet që janë të dallueshme duhet të njihen veças dhe ndonjë zbritje çmimi ose rabate në çmimin e kontratës duhet në përgjithësi të ndahen në elemente të veçanta. Kur konsiderata ndryshon për ndonjë arsye, shuma minimale duhet të njihet në qoftë se ato nuk janë në rrezik të rëndësishëm të ndryshimit kthyes. Shpenzimet e bëra për të siguruar kontrata me klientët duhet të kapitalizohen dhe të amortizohen gjatë periudhës kur përfitimet e kontratës konsumohen.

Ndryshimet në SNRF 15, Të ardhurat nga kontratat me klientët (publikuar më 12 prill 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1

janarit 2018). Ndryshimet nuk ndryshojnë parimet themelore të Standardit, por sqarojnë se si duhet të zbatohen këto parime. Ndryshimet sqarojnë se si për të identifikuar një detyrim të performancës (premtimin për të transferuar një mall apo një shërbim te një klient) në kontratë; si të përcaktohet nëse një kompani është kryesore (ofruese e një malli apo shërbimi) ose një agjent (përgjegjës për rregullimin për mall apo shërbim që do të ofrohet); dhe se si të përcaktohet nëse të ardhurat nga dhënia e licencës duhet të njihen në një moment në kohë ose me kalimin e kohës. Përveç sqarimeve, ndryshimet përfshijnë dy lehtësime shtesë për të ulur koston dhe kompleksitetin për një kompani, kur ajo së pari zbaton standardin e ri. Standardi i ri dhe ndryshimi nuk pritet të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të bankës.

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shpalosjen e qirave. Të gjitha qiratë rezultojnë në atë që qiramarrësi merr të drejtën për të përdorur një aktiv në fillim të qirasë dhe në qoftë se pagesat e qirasë janë bërë me kalimin e kohës edhe marrjen e financimit. Prandaj, SNRF 16-shi eliminon klasifikimin e qirave ose si qira operative, ose si qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe në vend të kësaj prezanton një model të vetëm të kontabilitetit për qiramarrësit. Për qiramarrësin do të jetë e nevojshme për t'i njohur: (a) aktivet dhe pasivet për të gjitha qiratë me afat prej më shumë se 12 muaj, përveç rasteve kur aktivi bazë është me vlerë të ulët; dhe (b) amortizimi i aktiveve me qira veçmas nga interesi për detyrimet e qirasë në pasqyrën e të ardhurave. SNRF 16-shi në thelb bart përpara kërkesat e kontabilitetit të qiradhënësit në SNK 17. Në përputhje me rrethanat, një qiradhënës vazhdon ta klasifikojë qiranë e saj si qira operative, ose si qira financiare dhe jep llogari për këto dy lloje të qirave ndryshe. Banka është duke vlerësuar ndikimin e standardit të ri në pasqyrat e saj financiare.

Iniciativa e Zbulimit - Ndryshimet në SNK 7 (publikuar më 29 janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017). SNK 7-shi i ndryshuar do të kërkojë dhënien e informacioneve shpjeguese në pajtim me lëvizjen në detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet financuese. Banka do ta paraqesë këtë zbulim në pasqyrat e saj financiare të vitit 2017.

Deklaratat e tjera të reja në vijim nuk pritet të kenë ndonjë ndikim material në bankë kur të miratohen:

- Shitja apo Kontributi i Aktiveve në mes të një investitori dhe bashkëpunëtori të tij ose sipërmarrjeje të përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe në SNK 28 (publikuar më 11 shtator 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas një date i cili do të përcaktohet nga BSNK-ja).
- Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e përcaktuara - Ndryshimet në SNK 12 (publikuar më 19 janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017).
- Ndryshimet në SNRF 2, Pagesa e bazuar në aksione (publikuar më 20 qershor 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Aplikimi SNRF 9, Instrumentet Financiare me SNRF 4, Kontratat e Sigurimit - Ndryshimet në SNRF 4 (publikuar më 12 shtator 2016 dhe në fuqi, në varësi të qasjes, për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 për subjektet të cilat zgjedhin për të aplikuar opsionin e përkohshëm të përjashtimit ose kur subjekti zbaton së pari SNRF 9-shin për subjektet që zgjedhin për të aplikuar qasjen e mbulesës).
- Përmirësimet vjetore të ciklit SNRF 2014-2016 (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017 për Ndryshimet në SNRF 12 dhe më ose pas 1 janarit 2018 për Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28).
- KFNIR 22 – Konsiderata e transaksioneve me valutë të huaj dhe paradhënie (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Transferet e Pronës së Investimeve - Ndryshimet në SNK 40 (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).

Përveç nëse përshkruhet ndryshe sipër, standardet dhe interpretimet e reja nuk pritet të ndikojnë dukshëm në pasqyrat financiare të bankës.

4. Gjykimet kritike kontabël dhe burimet kyç të pasigurisë së përlllogaritjes

Banka bën përlllogaritje dhe supozime që ndikojnë në shumën e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Përlllogaritjet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe duke u bazuar në përvojën historike dhe në faktorët e tjerë, përfshirë pritjet e ngjarjeve

të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme në kuadër të rrethanave.

(a) Supozimet dhe vlerësimet e pasigurive

Informacioni rreth supozimeve dhe vlerësimeve të pasigurive, e të cilat kanë një rrezik të rëndësishëm pasi mund të çojnë në rregullime materiale në vitet pasardhëse, është treguar më poshtë në lidhje me zhvlerësimin e instrumenteve financiare.

(I) Ngarkesa e zhvlerësimit për humbjet e kredisë Banka rishikon portofolin e saj të kredive për t'i vlerësuar zhvlerësimet së paku në baza tremujore. Gjatë përcaktimit të asaj nëse humbja e zhvlerësimit duhet të regjistrohet në pasqyrën e fitimit dhe të humbjes, banka bën gjykimin përkatazi me atë nëse ka të dhëna të vëzhgueshme, të cilat tregojnë se ka rënie të matshme në flukset e ardhshme monetare nga portofoli i kredive para se rënia të mundë të identifikohet me një kredi individuale në atë portofol. Kjo dëshmi mund të përfshijë të dhëna të vëzhgueshme duke treguar se ka pasur ndryshime të kundërta në statusin e pagesës së huadhënësve në një grup, ose kushtet ekonomike kombëtare, ose lokale që ndërliken me mospagesën në aktive në grup.

Menaxhmenti bën përlllogaritjet duke u bazuar në humbjen historike për aktivet me karakteristika rreziku të kredisë dhe dëshmi objektive të zhvlerësimit, të ngjashëm me ato në portofol gjatë programimit të flukseve monetare të ardhshme. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për përlllogaritjen e shumës dhe të kohës së rrjedhave të ardhshme të parasë së gatshme janë rishikuar në mënyrë të rregullt për t'i reduktuar dallimet ndërmjet përlllogaritjeve të humbjes dhe të përvojës së humbjes aktuale.

Një rritje apo një ulje prej 10% në humbjen reale në krahasim me humbjen e parashikuar të përdorur do të rezultonte në një rritje apo në një ulje në zhvlerësimin e kredive dhe të paradhëniesve për 1,646 mijë euro (2015: 1,709 mijë euro), respektivisht. Humbjet nga zhvlerësimi për kredi individuale të rëndësishme bazohen në vlerësimet e zbritjeve të flukseve monetare të ardhshme së kredive individuale, duke marrë parasysh pagesat dhe realizimin e çdo aktivi të mbajtur si kolateral ndaj kredive. Një rritje apo një ulje prej 10% në humbjen reale në krahasim me rrjedhën e parashikuar të zbritur të parasë nga kreditë individuale të rëndësishme,

që mund të ndodhin nga diferencat në shumat dhe kohën e flukseve monetare, do të rezultojnë në një rritje ose në një ulje në zhvlerësimin e kredisë dhe të humbjes për 946 mijë euro (2015: 1,567 mijë euro), respektivisht.

(II) Zhvlerësimi i investimeve të vlefshme për shitje Banka përcakton që investimet e vlefshme për shitje zhvlerësohen kur ka një rënie të madhe ose të zgjatur të vlerës reale nën koston e saj. Përcaktimi se çfarë është e rëndësishme ose e zgjatur kërkon gjykim. Gjatë gjykimit banka vlerëson ndërmjet faktorëve të tjerë paqëndrueshmërinë normale në çmimin e aksionit. Përveç kësaj, zhvlerësimi mund të jetë i mirëfilltë kur ka dëshmi të përkeqësimit të gjendjes financiare të investuesit, të industrisë dhe të performancës së sektorit, ndryshimeve në teknologji dhe në rrjedhat operative dhe financuese të parave të gatshme.

Nëse të gjitha rëniet e vlerës reale nën kosto do të kishin qenë të konsideruara si të rëndësishme ose si të zgjatura banka do t'i kishte edhe 233 mijë euro (2015: 6 mijë euro) humbje shtesë në pasqyrat e saj financiare, duke përbërë totalin e transferimit të rezervës me vlerë totale të drejtë ndaj fitimit dhe humbjes. Shih shënimin 24.

5. Menaxhimi i rrezikut financiar

Aktivitetet e bankës e ekspozojnë atë ndaj një numri rreziqesh dhe këto aktivitete përfshijnë analiza, vlerësim, pranueshmëri dhe menaxhim të një shkalle të rrezikut ose kombinimit të rreziqeve. Pranimi i rrezikut është thelbësor për biznesin financiar dhe rreziqet operative janë një pasojë e pashmangshme e të qenit në biznes. Prandaj, synimi i bankës është arritja e një ekuilibri të përshtatshëm ndërmjet rrezikut dhe kthimit, si dhe minimizimi i efekteve negative të mundshme në performancën financiare të bankës.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të bankës janë krijuar për t'i identifikuar dhe për t'i analizuar këto rreziqe, për t'i përcaktuar limitet dhe kontrollet e rrezikut dhe për t'i monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve përmes sistemeve të besueshme dhe të përditësuara informative. Banka në mënyrë të rregullt rishikon politikat e saj të menaxhimit të rrezikut dhe sistemet për t'i reflektuar ndryshimet në tregje, produkte dhe praktika më të mira të reja.

5. Menaxhimi i rrezikut kryhet në mënyrë primare nga Departamenti i Rrezikut dhe Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut Kreditor në Bankë, i cili punon në kuadër të politikave të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve. Bordi ofron parime të shkruara për menaxhimin e përgjithshëm të rrezikut, si dhe politika të shkruara që mbulojnë fushat specifike, siç janë: rreziqet kreditore, rreziku i shkëmbimit të valutave të huaja, rreziku i normës së interesit dhe rreziku i likuiditetit. Gjithashtu, auditimi i brendshëm është përgjegjës për rishikim të pavarur të menaxhimit të rrezikut dhe mjedisit të kontrollit.

(a) Rreziku i kredisë

Banka mbart ekspozim ndaj rrezikut të kredisë, i cili është rrezik që pala e tretë do të shkaktojë një humbje financiare për bankën duke dështuar të përmbushë një detyrim. Rreziku i kredisë është rreziku më i rëndësishëm për biznesin e bankës, prandaj menaxhmenti me kujdes përcaktojnë ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë. Ekspozimet e kredisë rrjedhin kryesisht nga aktivitetet e huazimit që sjellin kredi dhe pagesa në paradhënie, si dhe nga aktivitetet në investime që sjellin vendosjet dhe letrat me vlerë të borxhit në portofolin e Aktiveve të Bankës.

Ka gjithashtu rrezik të kredisë nga instrumentet financiare jashtë bilancit, siç janë letrat e kredive, garancitë dhe zotimet e kredive. Menaxhimi i rrezikut të kredisë, kontrolli për kredi dhe pagesa në paradhënie janë të centralizuara në Departamentin e Menaxhimit të Rrezikut të Kredisë, ndërsa rreziku ndërmjet bankave për vendosje dhe letra me vlerë të borxhit janë koncentruar në departamentet e Thesarit dhe Menaxhimit të Rrezikut. Të gjitha departamentet përgjegjëse për menaxhimin e rrezikut të kredisë dhe kontrollet raportojnë në Bordin Menaxhues dhe në Bordin e Drejtorëve në mënyrë të rregullt.

(I) Analiza e cilësisë së kredisë

Tabela më poshtë përcakton informacione mbi cilësinë e kredisë së aktiveve financiare dhe fondet për dëmtimet/humbjet nga rënia në vlerë, të mbajtura nga banka kundrejt këtyre aktiveve.

Tabela më poshtë paraqet rastin më të keq të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë për bankën, për datën 31 dhjetor 2016 dhe 2015, pa marrë në konsideratë kolaterale të mbajtura ose mbrojtje të tjera, të bashkëngjitura kredive. Për aktivet financiare ekspozimet e mëposhtme paraqesin vlerën e mbartur ashtu si është raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë

	31 dhjetor 2016		31 dhjetor 2015	
	Vlera kontabël	Shuma e zotuar/garantuar	Vlera kontabël	Shuma e zotuar/garantuar
Saldot me Bankën Qendrore dhe Bonot e Thesarit				
me maturitet më të vogël se 3 muaj	65,280	-	79,872	-
Kredi dhe avanca ndaj bankave	67,004	-	81,861	-
Kredi dhe avanca ndaj bankave	452,514	-	436,730	-
Aktivitet financiarë të gatshme për shitje				
Aktive financiare	131,378	-	88,012	-
Aktive të tjera financiare	5,112	-	1,941	-
Zotimet dhe garancitë e kredihënies	-	88,368	-	85,591
Totali	721,288	88,368	688,416	85,591
 <i>Jashtë gjendjes së bilancit</i>				
		31 dhjetor 2016		31 dhjetor 2015
Zotimet kreditore		61,280		55,946
Garancitë financiare		26,552		28,094
Letrat e kredisë		536		1,551
		88,368		85,591
Provizionet e njohura si detyrim		(260)		(278)
Totali		88,108		85,313

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

(I) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim) Paratë e gatshme dhe gjendjet me bankat qendrore

Cilësia e kredihënies në para të gatshme dhe gjendjet me bankat qendrore jepet si më poshtë. Banka Qendrore e Kosovës dhe Qeveria e Kosovës nuk janë kategorizuar nga ndonjë agjenci e njohur për kategorizim.

	Vlerësimi Fitch	Gjendja e para- ve të gatshme me bankat qendrore, duke përfshirë rezervat e detyrueshme	Letrat me vlerë nga Qeveria e Kosovës me maturitet më të vogël se 3 muaj	Totali
Në mijëra euro				
31 dhjetor 2016				
Pa vonesa dhe zhvlerësime				
Banka Qendrore e Kosovës	Pa kategorizim			
- Llogaritë rrjedhëse		7,309	-	7,309
- Rezervat e detyrueshme		37,610	-	37,610
- Letrat me vlerë të Qeverisë		-	3,000	3,000
Banka Qendrore e Republikës së Gjermanisë ("Deutsche Bundesbank")				
	AAA	17,361	-	17,361
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, duke mos përfshirë paratë e gatshme në dorë				
		62,280	3,000	65,280

	Vlerësimi Fitch	Gjendja e para- ve të gatshme me bankat qendrore, duke përfshirë rezervat e detyrueshme	Letrat me vlerë nga Qeveria e Kosovës me maturitet më të vogël se 3 muaj	Totali
Në mijëra euro				
31 dhjetor 2015				
Pa vonesa dhe zhvlerësime				
Banka Qendrore e Kosovës	Pa kategorizim			
- Llogaritë rrjedhëse		52,546	-	52,546
- Rezervat e detyrueshme		24,678	-	24,678
- Letrat me vlerë të Qeverisë		-	250	250
Banka Qendrore e Republikës së Gjermanisë ("Deutsche Bundesbank")				
	AAA	2,398	-	2,398
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, duke mos përfshirë paratë e gatshme në dorë				
		79,622	250	79,872

Te drejta ndaj bankave

Ekspozimet ndërbankare monitorohen nga afër çdo ditë nga menaxhimi i rrezikut dhe Departamenti i Thesarit. Banka kufizon depozitat e saj dhe transakcionet e tjera bankare me bankat lokale apo ndërkombëtare në gjendje të shëndetshme. Para se një marrëdhënie biznesi të nisë me një bankë të caktuar, Departamenti i Rrezikut dhe menaxhimi kryejnë një analizë të gjendjes financiare të institucionit. Performanca financiare e palëve të tjera monitorohet vazhdimisht. Për më tepër, të gjitha bankat korrespondente, si dhe emetuesit e

obligacioneve në të cilat banka ka ekspozime të investimeve, monitorohen vazhdimisht për renditjen e tyre nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit si: "Standard & Poor's" (S & P), "Fitch" dhe "Moody's". Një funksion i pavarur nga Departamenti i Thesarit, zakonisht menaxhimi i rrezikut, duhet të monitorojë se ekspozimi ndaj të gjitha bankave nuk i kalon limitet rregullatore ose limitet e brendshme të vendosura nga menaxhmenti i bankës. Kështu, menaxhimi i rrezikut mbështet Departamentin e Thesarit, duke siguruar raporte ditore që tregojnë

ekspozimet dhe depozitat që mund të bëhen për të gjitha bankat korrespondente pa shkelur kufijtë e ekspozimit të pranishëm. Në përputhje me Rregulloren e re mbi Ekspozimet e Mëdha të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, bankat nuk do të kenë asnjë ekspozim total të rrezikut të kredisë ndaj palëve të lidhura që tejkalon 15% të klasës I, të kapitalit rregullator. Gjithashtu, për të reduktuar më tej rrezikun e palës korresponduese, KPD-ja miraton kufizime të brendshme për ekspozimet ndaj palës korresponduese pak më ulët se kërkesat rregullatore, kufij të cilët janë respektuar vazhdimisht nga banka.

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

(I) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim) Detyrime ndaj bankave (vazhdim)

Kreditë dhe paradhëniet ndaj bankave aprovohen pa kolateral. Tabela më poshtë paraqet llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me afat në bankat gjegjëse nga kategorizimet e kredidhënies:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Pa vonesa dhe zhvlerësime:		
- AA+ to AA-	33,636	34,859
- A+ to A-	14,085	22,960
- BBB+ to B-	19,283	24,042
Borxhi total nga banka të tjera	67,004	81,861

Kredi dhe avanca për klientë

31 dhjetor 2016	Private	Biznes	Totali
Shuma bruto në total	139,825	335,191	475,016
Fonde për zhvlerësime (individuale dhe kolektive)	(7,911)	(14,591)	(22,502)
Vlera e mbartur neto	131,914	320,600	452,514
Me kosto të amortizuar			
Pa vonesa dhe zhvlerësime	129,599	310,480	440,079
Me vonesa dhe të pazhvlerësuara	5,811	8,697	14,508
Të zhvlerësuara	4,415	16,014	20,429
Shuma bruto në total	139,825	335,191	475,016
Fonde për zhvlerësime (individuale dhe kolektive)	(7,911)	(14,591)	(22,502)
Vlera e mbartur neto	131,914	320,600	452,514
Kreditë me kushte të negociuara			
Vlera e mbartur	3,505	25,936	29,441
Nga të cilat: të pazhvlerësuara	1,242	10,998	12,240
Fonde për zhvlerësim	(1,510)	(5,319)	(6,829)
Vlera e mbartur neto	1,995	20,617	22,612
Me vonesa dhe të pazhvlerësuara			
Me vonesa 0 – 30 ditë	3,477	7,340	10,817
Me vonesa 31 – 90 ditë	1,267	741	2,008
Me vonesa mbi– 180 ditë	1,067	616	1,683
	5,811	8,697	14,508
Të zhvlerësuara			
Me vonesa 0 – 30 ditë	498	8,342	8,840
Me vonesa 31 – 90 ditë	129	1,766	1,895
Me vonesa 91 – 180 ditë	114	2,026	2,141
Me vonesa mbi 180 ditë	3,674	3,880	7,553
	4,415	16,014	20,429
Fonde për zhvlerësim			
Individuale	(1,652)	(8,585)	(10,237)
Kolektive	(6,259)	(6,006)	(12,265)
Totali i fondeve për zhvlerësim	(7,911)	(14,591)	(22,502)

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

(I) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

31 dhjetor 2015	Private	Biznes	Totali
Shuma totale bruto	131,916	330,654	462,570
Fonde për zhvlerësim (individuale dhe kolektive)	(7,297)	(18,543)	(25,840)
Vlera e mbartur neto	124,619	312,111	436,730
Me kosto të amortizuar			
Pa vonesa dhe zhvlerësime	122,537	296,863	419,400
Me vonesa dhe të pazhvlerësuara	5,615	7,769	13,384
Të zhvlerësuara	3,764	26,022	29,786
Shuma totale bruto	131,916	330,654	462,570
Fonde për zhvlerësim (individuale dhe kolektive)	(7,297)	(18,543)	(25,840)
Vlera e mbartur neto	124,619	312,111	436,730
Kreditë me kushte të negociuara			
Vlera e mbartur	2,544	42,433	44,977
Nga të cilat: të pazhvlerësuara	705	21,322	22,027
Fonde për zhvlerësim	(953)	(9,626)	(10,579)
Vlera e mbartur neto	1,591	32,807	34,398
Me vonesa dhe të pazhvlerësuara			
Me vonesa 0 – 30 ditë	2,907	5,710	8,617
Me vonesa 31 – 90 ditë	1,409	1,247	2,656
Me vonesa mbi– 180 ditë	1,299	812	2,111
	5,615	7,769	13,384
Të zhvlerësuara			
Me vonesa 0 – 30 ditë	443	16,194	16,637
Me vonesa 31 – 90 ditë	157	742	899
Me vonesa 91 – 180 ditë	65	1,895	1,960
Me vonesa mbi 180 ditë	3,099	7,191	10,290
	3,764	26,022	29,786
Fonde për zhvlerësim			
Individuale	(1,096)	(11,708)	(12,804)
Kolektive	(6,201)	(6,835)	(13,036)
Totali i fondeve për zhvlerësim	(7,297)	(18,543)	(25,840)

Zhvlerësime dhe provizionime

Provizionet e rënies së vlerës (zhvlerësimi) regjistrohen për qëllime të raportimit financiar vetëm për humbjet që janë shkaktuar në datën e raportimit, duke u bazuar në dëshminë objektive të zhvlerësimit (shihni shënimin 2.(g)(VII)). Politika e bankës kërkon rishikimin e aktiveve individuale financiare që janë mbi pragjet e materialitetit së paku një herë në vit ose në mënyrë më të rregullt kur kjo kërkohet nga rrethanat. Lejimet ose fondet e zhvlerësimeve në llogaritë e vlerësuara në baza individuale janë përcaktuar përmes vlerësimit të

humbjes së shkaktuar në datën e raportimit rast për rast dhe aplikohen për të gjitha llogaritë e rëndësishme individuale. Vlerësimi zakonisht përfshin kolateralin e mbajtur (duke përfshirë rikonfirmimin e ekzekutimit të tij) dhe pranimet e pritura për atë llogari individuale. Vlerësimi kolektiv i zhvlerësimit të një grupi të aktiveve financiare bazohet në analizën kuantitative të normave të mospagesës historike për portofolin e kredisë me karakteristika të ngjashme. Normat kuantitative të mospagesës të kalkuluar në këtë mënyrë i janë nënshtruar një analize kualitative (analizë migrimi).

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

(I) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve (vazhdim)

Sipas metodologjisë së brendshme, banka përcakton zhvlerësimin e kredive të humbura në përputhje me alokimin e ekspozimit të kredisë në tri kategori të ndryshme si më poshtë:

Zhvlerësime individuale specifike: Në këtë kategori banka njeh provizionin për të gjitha ekspozimet e rëndësishme kreditore individuale që janë zhvlerësuar.

Provizionet e bazuara në portofol: Në këtë kategori banka provizionon të gjitha ekspozimet e kredive për të cilat ajo përcakton që nuk tregojnë shenja objektive zhvlerësimi sipas karakteristikave të tyre të ngjashme.

Provizionet specifike paushallë: Në këtë kategori banka provizionon individualisht të gjitha ekspozimet e kredive jo të rëndësishme kreditore që janë zhvlerësuar, duke u bazuar në numrin e ditëve të vonesave (d.m.th. më shumë se 30 ditë vonesë).

Kredi me vonesë, por të pazhvlerësuar

Kredive të cilave u ka kaluar afati, por nuk janë zhvlerësuar janë ato kredi ku interesi kontraktual ose i pagesave të kryegjësë u ka kaluar afati, por banka beson se zhvlerësimi nuk është i përshtatshëm në bazë të nivelit të sigurisë/kolateralit të disponueshëm dhe/apo në stadin e mbledhjes së shumave që i detyrohen bankës.

Kreditë me kushte të ristrukturuara

Kredi me kushte të ristrukturuara janë kreditë, të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të kredimarrësit dhe ku banka ka bërë lëshime, të cilat në një rast tjetër nuk do t'i konsideronte. Një vendim për të ristrukturuar i nënshtrohet kushteve në vijim:

- Ristrukturimi rrit mundësinë që kredimarrësi do të jetë në gjendje të paguajë ekspozimin kreditor;
- Ristrukturimi rrit mundësinë që banka të rikuperojë borxhin e papaguar më shpejt në një shkallë më të madhe dhe/ose me një kosto më të ulët që do të mundë të arrihej përmes procesit ligjor të rikuperimit;
- Plani i ri i pagesave është në përputhje me kapacitetin e tanishëm dhe të ardhshëm të kredimarrësit;

- Kredimarrësi ofron kolateral shtesë, nëse është e mundur dhe e përshtatshme.

Duke u bazuar tek lloji i ristrukturimit (standarde ose të zhvlerësuar) ekspozimi i kredisë mund të kategorizohet ose jo në një kategori më të mirë, duke u bazuar në performancën e ekspozimit. Kreditë e zhvlerësuar të ristrukturuara qëndrojnë në të njëjtën kategori, pavarësisht nga performanca pas ristrukturimit...

Politika e fshirjes

Banka nxjerr jashtë pasqyrave një kredi (dhe çdo fond për humbjet prej saj) kur është përcaktuar që kjo kredi është e parikuperueshme. Ky përcaktim arrihet pasi merret në konsideratë informacioni për gjendjen financiare të kredimarrësit, i cili nuk mund të paguajë detyrimin e tij ose kur të ardhurat nga shitja e kolateralit nuk janë të mjaftueshme për ta mbuluar të gjithë ekspozimin. Sa më të vogla shumat e mbetura, sa më i madh numri i ditëve me vonesë dhe sa më të mëdha janë paqartësitë rreth përmirësimit (të tilla si kushtet ligjore të paparashikueshme), aq më të vogla do të jenë mundësitë e mbledhjes së borxhit nga banka.

Aktivitet financiar të vlefshme për shitje

Investimet në letrat me vlerë të borxhit të qeverive, bankave qendrore dhe kredimarrësve të tjerë mbikombëtarë të vlerësuar si AA - ose më lart nga "Fitch", "S & P" ose "Moody's". Ekspozimi ndaj letrave me vlerë të borxhit është i rregulluar me politikën e investimeve. Investimet janë të lejuara vetëm në letrat me vlerë likuide që kanë vlerësim të lartë. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor përfaqësohet nga vlera kontabël neto e çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar.

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)
(I) Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)
Aktivët financiarë të vlefshme për shitje (vazhdim)

Tabela më poshtë paraqet komplet portofolin, i cili përfshin letrat me vlerë që nuk lidhen me Qeverinë e Kosovës:

	Letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës	OECD Bonot e Qeverisë	Totali
31 dhjetor 2016			
<i>Pa vonesa dhe zhvlerësime:</i>			
- AA+ deri në AA-	-	25,316	25,316
- A+ deri në A-	-	81,460	81,460
- BBB+ deri në B-	24,602	-	24,602
Borxhi total i letrave me vlerë të vlefshme për shitje	24,602	106,776	131,378

	OECD Bonot e Qeverisë	OECD Bonot e Qeverisë	Totali
31 dhjetor 2015			
<i>Pa vonesa dhe zhvlerësime</i>			
- AAA	-	56,227	56,227
- AA+	-	7,485	7,485
Te pakategorizuara (në nivel shteti ose qeverie)	24,300	-	24,300
Borxhi total i letrave me vlerë të vlefshme për shitje	24,300	63,712	88,012

Zotimet e kredidhënies dhe garancitë financiare

Ekspozimi maksimal nga garancitë financiare përfaqëson shumën maksimale që banka duhet ta paguajë nëse garancia kërkohet, e cila mund të jetë në mënyrë të konsiderueshme më e madhe sesa shumata e njohur si detyrim. Ekspozimi maksimal i kredisë për zotimet e kredidhënies është shumata plotë e zotimit (Shënimi 26).

(I) Kontrolli i limitit të rrezikut dhe politikat reduktuese

Banka menaxhon limitet dhe kontrollon përqendrimet e rrezikut të kredisë kudo që këto janë identifikuar, në mënyrë të veçantë me palë individuale dhe grupe dhe palë të lidhura. Banka strukturon nivelet e rrezikut të kredisë që ajo ndërmerr duke vendosur limite në shumën e rrezikut të pranuar në lidhje me një kredimarrës ose grup kredimarrës dhe për segmentet gjeografike e industriale. Rreziqet e tilla monitorohen rregullisht dhe i nënshtrohen një rishikimi vjetor ose më të shpeshtë, nëse është e nevojshme. Limitet në nivelin e rrezikut të kredisë sipas produktit, rajonit dhe sektorit të industrisë

janë aprovuar nga Bordi Drejtues. Ekspozimi ndaj rrezikut të kredidhënies menaxhohet përmes një analize të rregullt të aftësisë së kredimarrësit dhe kredimarrësve të mundshëm për ta përbushur shlyerjen e detyrimeve të interesit dhe të kapitalit dhe duke ndryshuar këto limite kredidhënieje, kur është e përshtatshme. Kontrollat e tjera dhe masat reduktuese janë përshkruar më poshtë.

Kolaterali i mbajtur e përmirësime kreditore të tjera dhe efekti i tyre financiar

Banka përdor një numër politikash dhe praktikash për ta ulur rrezikun e kredisë, ku më e zakonshmeja është marrja e sigurisë dhe e kolateralëve për fondet e dhëna. Banka zbaton udhëzime mbi pranueshmërinë e llojeve specifike të kolateralit, si dhe uljen e rrezikut të kredisë. Llojet kryesore të kolateralit për kreditë dhe paradhëniet janë:

- Hipoteka mbi pronat e banimit;
- Pengu mbi aktivet e biznesit të tilla si: ndërtesa, pajisje dhe inventarë;
- Pengu mbi para dhe ekuivalentet e mjeteve monetare (kolateral me mjete monetare).

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

(II) Kontrolli i limitit të rrezikut dhe politikat reduktuese

Kreditë për korporatat dhe individët janë në përgjithësi të siguruara. Mbitërheqje private individuale dhe kartat e kreditit të lëshuara për individët janë të siguruara me para të gatshme ose lloje të tjera të kolateralit të përcaktuara me vendim të komiteteve të kreditit. Përveç kësaj, për ta minimizuar humbjen e kredisë banka do të kërkojë

kolateral shtesë nga pala sapo vihen re tregues zhvlerësimi për kreditë dhe paradhëniet përkatëse individuale.

Efekti financiar i kolateralit është paraqitur duke shpalosur vlerat e kolateraleve veçmas për

- ato aktive ku kolaterali e përmirësimet dhe siguritë e tjera janë të barabarta ose kalojnë vlerën e mbarëtur të aktiveve ('Aktivet e mbikolateralizuara'), dhe

- ato aktive ku kolaterali e përmirësimet dhe siguritë e tjera më pak se vlera e mbarëtur e aktiveve ('Aktivet e nënkolateralizuara').

	Aktivet e mbikolateralizuara		Aktivet e nënkolateralizuara	
	Vlera e mbarëtur e aktiveve	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera e mbarëtur e aktiveve	Vlera e drejtë e kolateralit
Më 31 dhjetor 2016				
Biznesi	222,497	718,041	98,104	75,670
Privat	36,263	116,353	95,650	29,755
	258,760	834,394	193,754	105,425

	Aktivet e mbikolateralizuara		Aktivet e nënkolateralizuara	
	Vlera e mbarëtur e aktiveve	Vlera e drejtë e kolateralit	Vlera e mbarëtur e aktiveve	Vlera e drejtë e kolateralit
Më 31 dhjetor 2015				
Biznes	242,787	828,461	69,325	58,478
Private	33,958	106,520	90,660	36,680
	276,745	934,981	159,985	95,158

Vlera e drejtë e kolateralit është vlerësuar nga banka mbi baza individuale. Vlera e vlerësuar paraqet vlerën reale të tregut. Të ardhurat e pritshme nga likuidimi i kolateralit është marrë gjithashtu në konsideratë në llogaritjen e provizionit individual për zhvlerësim.

(I) Përqendrimi i rrezikut të kredisë

Përqendrimet lindin kur një numër i palëve të tjera është i angazhuar në aktivitete të ngjashme të biznesit apo veprimtari në të njëjtin rajon gjeografik, ose kanë karakteristika të ngjashme ekonomike që do të shkaktojnë ndikime të ngjashme në aftësinë e tyre për t'i përmbushur detyrimet kontraktuale si rrjedhojë e ndryshimeve në kushtet ekonomike, politike apo të tjera. Përqendrimet tregojnë ndjeshmërinë relative të performancës së bankës ndaj zhvillimeve që ndikojnë në një industri të veçantë ose zonë gjeografike.

1) Sektorët gjeografikë

Tabela e mëposhtme ndan ekspozimin kryesor të kredisë së bankës në shumat bruto, siç janë kategorizuar sipas rajonit gjeografik, më 31 dhjetor 2016 dhe 2015. Banka ka alokuar ekspozimet sipas rajoneve, duke u bazuar në vendin e qëndrimit të palës tjetër.

**5. Menaxhimi i rrezikut financiar
(vazhdim)
(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)
(III) Përqendrimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)**

	2016			2015		
	Shtetet e OECD	Kosova	Totali	Shtetet e OECD	Kosova	Totali
Aktive						
Gjendja me Bankën Qendrore	17,361	47,919	65,280	2,398	77,474	79,872
Kredi dhe paradhënie për bankat	67,004	-	67,004	81,861	-	81,861
Kredi dhe paradhënie për klientët	-	452,514	452,514	-	436,730	436,730
Aktivitet financiar të vlefshme për shitje	106,776	24,602	131,378	63,712	24,300	88,012
Aktive të tjera financiare	-	5,112	5,112	-	1,941	1,941
	191,141	530,147	721,288	147,971	540,445	688,416
Detyrime						
Detyrime ndaj bankave	99	128	227	124	125	249
Detyrime ndaj klientëve	42,699	646,144	688,843	44,125	633,932	678,057
Huatë	10,034	-	10,034	8,021	-	8,021
Borxhi i varur	7,645	-	7,645	7,647	-	7,647
Detyrime të tjera financiare	-	1,385	1,385	-	1,267	1,267
	60,477	647,657	708,134	59,917	635,324	695,241

Industria

	2016			2015		
	Private	Biznes	Totali	Private	Biznes	Totali
Aktive						
Gjendja me Bankën Qendrore	-	65,280	65,280	-	79,872	79,872
Kredi dhe paradhënie për bankat	-	67,004	67,004	-	81,861	81,861
Kredi dhe paradhënie për klientët	128,826	323,688	452,514	124,221	312,509	436,730
Aktivitet financiar të vlefshme për shitje	-	131,378	131,378	-	88,012	88,012
Aktive të tjera financiare	-	5,112	5,112	-	1,941	1,941
Totali i aktiveve	128,826	592,462	721,288	124,221	564,195	688,416
Detyrimet						
Detyrime ndaj bankave	-	227	227	-	249	249
Detyrime ndaj klientëve	545,081	143,762	688,843	549,787	128,270	678,057
Huatë	-	10,034	10,034	-	8,021	8,021
Borxhi i varur	-	7,645	7,645	-	7,647	7,647
Detyrime të tjera financiare	-	1,385	1,385	-	1,267	1,267
Totali i detyrimeve	545,081	163,053	708,134	549,787	145,454	695,241

(a) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, siç janë normat e interesit, çmimet e ekuitetit, normat e këmbimit të huaj dhe shpërndarjet e kredive (që nuk lidhen me ndryshimet në pozitën kreditore të emetuesit/obligatorit), do të

ndikojnë në të ardhurat e bankës ose në vlerën e investimeve në instrumentet financiare të saj. Objektivi i menaxhimi të rrezikut të tregut është që t'i menaxhojë dhe t'i kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin ndaj rrezikut.

(I) Rreziku i valutës së huaj

Rreziku i valutës është rreziku që vlera e instrumentit financiar do të ndryshojë për shkak të ndryshimeve në normat e këmbimit të valutës së huaj. Banka nuk synon të fitojë nga ndonjë transaksion spekulativ, por mundohet ta mbajë pozitën e saj të hapur afër zeros gjatë gjithë kohës. Limitet e pozitës së hapur valutore dhe kapaciteti i pranimit të rrezikut për bankën janë përcaktuar sipas politikave përkatëse, të cilat janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve dhe janë rishikuar në baza javore nga Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut. Përveç kësaj, limitet rregullatore janë zbatuar gjatë tërë kohës nga ana e bankës.

Njësia e Thesarit vlerëson kursin e këmbimit të valutës së huaj lidhur me të gjitha pozitat materiale të valutës. Janë shqyrtuar ndryshimet e strukturës së aktiveve dhe të detyrimeve të denominuara në valutën e huaj dhe ndikimin e tyre para se tregtimet të ekzekutohen nga Departamenti i Thesarit të

Bankës.

Njësia e Thesarit vëzhgon tregun financiar dhe informon Departamentin e Menaxhimit të Rrezikut rregullisht dhe në rast se ka zhvillime me rëndësi që mund të ndikojnë në situatën me rrezikun e valutës së bankës.

Edhe pse banka ka për qëllim ta mbajë aq sa mundet valutën e vet sa më afër zeros, prapë ka raste kur banka mund të preket nga një paqëndrueshmëri e paparashikueshme e kursit të këmbimit. Atëhere, Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut kryen teste të stresit dhe i raporton efektet në P&L-në e Bankës në baza tremujore.

Normat zyrtare për valutat kryesore të përdorura në kthimin e zërave në valutë të huaj janë si më poshtë (në euro):

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
1 USD	0.9487	0.9185
1 CHF	0.9312	0.9229
1 GBP	1.1680	1.3625

Tabela në vijim përmbledh aktivet dhe detyrimet e bankës në valutat e huaja, më 31 dhjetor 2016 dhe 2015, të kthyera në mijë EUR '000.

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(a) Rreziku i tregut (vazhdim)

(I) Rreziku i valutës së huaj (vazhdim)

31 dhjetor 2016	EUR	USD	CHF	GBP	Totali
Aktive					
Gjendja me Bankën Qendrore	120,380	319	546	19	121,264
Kredi dhe paradhënie për bankat	52,417	14,088	435	64	67,004
Kredi dhe paradhënie për klientët	451,320	1,194	-	-	452,514
Aktivët financiarë të vlefshme për shitje	121,890	9,488	-	-	131,378
Aktive të tjera financiare	4,519	593	-	-	5,112
Totali i aktiveve të financave monetare	750,526	25,682	981	83	777,272
Detyrime					
Detyrime ndaj bankave	226	-	1	-	227
Detyrime ndaj klientëve	661,999	25,812	950	82	688,843
Hua dhe detyrime të varura	17,679	-	-	-	17,679
Detyrime të tjera financiare	1,212	173	-	-	1,385
Totali i detyrimeve financiare monetare	681,116	25,985	951	82	708,134
Pozita financiare e bilancit neto	69,410	(303)	30	1	69,138
Zotimet e kredisë	61,224	56	-	-	61,280
Letrat me vlerë - jashtë bilancit	529	7	-	-	536
Garancitë bankare – jashtë bilancit	26,457	95	-	-	26,552
Zotimet lidhur me totalin e kredisë	88,210	158	-	-	88,368

31 dhjetor 2015	EUR	USD	CHF	GBP	Totali
Aktivitet					
Gjendja me Bankën Qendrore	161,516	1,114	1,895	283	164,808
Kredi dhe paradhënie për bankat	67,269	13,794	677	121	81,861
Kredi dhe paradhënie për klientët	434,282	2,448	-	-	436,730
Aktivitet financiarë të vlefshme për shitje	80,586	7,426	-	-	88,012
Aktive të tjera financiare	1,367	574	-	-	1,941
Totali	745,020	25,356	2,572	404	773,352
Detyrime					
Detyrime ndaj bankave	248	-	1	-	249
Detyrime ndaj klientëve	649,550	25,453	2,647	407	678,057
Hua dhe detyrime të varura	15,668	-	-	-	15,668
Detyrime të tjera financiare	1,267	-	-	-	1,267
Totali	666,733	25,453	2,648	407	695,241
Pozita financiare e bilancit neto	78,287	(97)	(76)	(3)	78,111
Zotimet e kredisë	55,786	160	-	-	55,946
Letrat me vlerë - jashtë bilancit	1,551	-	-	-	1,551
Garancitë bankare – jashtë bilancit	27,865	229	-	-	28,094
Zotimet lidhur me totalin e kredisë	85,202	389	-	-	85,591

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(a) Rreziku i tregut (vazhdim)

(I) Rreziku i valutës së huaj (vazhdim)

Tabela më poshtë përmbledh analizën e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të valutës së huaj dhe efektin mbi fitimin dhe humbjen:

	Rritja 2016	Rritja 2015	Efekti mbi fitimin, humbjen dhe kapitalin neto	
			31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
USD	10%	10%	32	11
Të tjera	10%	10%	3	8

(II) Rreziku i normës së interesit

Banka ekspozohet ndaj rreziqeve të ndryshme që shoqërojnë efektet e luhatjeve të normave të interesit të tregut në pozitën e saj financiare dhe në rrjedhat e parasë së gatshme. Në kontrast me bankat e tjera tregtare, bankat “ProCredit” nuk synojnë të bëjnë fitime përmes transformimit të maturitetit ose formave të tjera të spekulimit në tregun e normës së interesit. Në vend të kësaj, banka kërkon të sigurojë që struktura e aktiveve dhe e pasiveve është balancuar përgjatë të gjitha maturiteteve. Menaxhimi i rrezikut të normës së interesit të

bankës është në pajtim me Bazel II. Ai merr parasysh si të ndjeshme ndaj normës së interesit vetëm kryegjënë (vlerën emërore); ndryshimet në interesin e përlloritur dhe ndryshimet në vlerën reale janë konsideruar si jo të ndjeshme ndaj normës së interesit.

Tabelat më poshtë përmbledhin ekspozimin e bankës ndaj rreziqeve të normës së interesit. Të përfshira në tabela janë aktivitetet dhe detyrimet monetare të bankës, me interesa fikse dhe jofikse.

**5. Menaxhimi i rrezikut financiar
(vazhdim)
(b) Rreziku i tregu (vazhdim)
(II) Rreziku i normës së interesit (vazhdim)**

Hendeku i ndjeshmërisë së interesit në euro, më 31 dhjetor 2015	Deri në 1 muaj	1-6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	2-5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Ndjeshmëria totale e interesit	Pa ndjeshmëri ndaj interesit
Aktivët								
Para të gatshme	-	-	-	-	-	-	-	83,822
Gjendja me banka qendrore	250	-	-	-	-	-	250	79,622
Llogaritë rrjedhëse me bankat	16,681	-	-	-	-	-	16,681	2,539
Bonot e thesarit dhe letrat me vlerë të tregtueshme								
Fikse	2,000	13,700	21,000	23,100	550	-	60,350	2,070
Variabël	-	18,000	-	-	-	-	18,000	166
Depozitat me afat me bankat	20,900	27,950	-	-	-	-	48,850	(3)
Kreditë dhe paradhëniet për klientët								
Fikse	22,024	84,957	100,245	93,867	111,748	15,316	428,156	2,413
Variabël	3,713	-	-	-	-	-	3,713	
Aktive të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	1,367
Totali i aktiveve	65,568	144,607	121,245	116,967	112,298	15,316	576,000	171,966
Detyrimet								
Llogari rrjedhëse të bankave	-	-	-	-	-	-	-	249
Llogari rrjedhëse të klientëve	30,074	20,050	24,059	48,118	78,192	-	200,493	351,038
Depozita nga klientët	9,515	26,426	38,865	12,064	9,894	491	97,255	3,818
Hua dhe borxhi i varur								
Fikse	-	-	-	-	-	8,000	8,000	21
Variabël	-	7,500	-	-	-	-	7,500	147
Detyrime të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	574
Totali i detyrimeve	39,589	53,976	62,924	60,182	88,086	8,491	313,248	355,847
Hendeku i ndjeshmërisë së normës së interesit - pozicioni i hapur								
	25,979	90,631	58,321	56,785	24,212	6,825	262,752	n/a

**5. Menaxhimi i rrezikut financiar
(vazhdim)
(b) Rreziku i tregu (vazhdim)
(II) Rreziku i normës së interesit (vazhdim)**

Hendeku i ndjeshmërisë së interesit në euro, më 31 dhjetor 2016	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	2-5 vjet	Ndjeshmëria totale e interesit	Pa ndjeshmëri ndaj interesit
Aktivët	-	-	-	-	-	-	319
Para të gatshme	4,083	-	-	-	-	4,083	-
Saldot me banka qendrore							
Fikse	-	-	-	9,487	-	9,487	-
Llogaritë rrjedhëse me bankat	4,743	5,218	-	-	-	9,961	44
Bonot e thesarit dhe letrat me vlerë të tregtueshme							
Fikse	75	1,025	94	-	-	1,193	2
	-	-	-	-	-	-	593
Totali i aktiveve	8,901	6,243	94	9,487	-	24,724	958
Llogari rrjedhëse të klientëve	1,195	797	956	1,913	3,108	7,969	17,642
Depozita nga klientët	2	85	114	-	-	201	1
Detyrime të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	173
Totali i detyrimeve	1,197	882	1,070	1,913	3,108	8,170	17,816
Hendeku i ndjeshmërisë së normës së interesit - pozicioni i hapur	7,704	5,361	(976)	7,574	(3,108)	16,554	n/a
Më 31 dhjetor 2015	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	2-5 vjet	Ndjeshmëria totale e interesit	Pa ndjeshmëri ndaj interesit
Para të gatshme	-	-	-	-	-	-	1,114
Llogaritë rrjedhëse me bankat	6,138	-	-	-	-	6,138	755
Bonot e thesarit dhe letrat me vlerë të tregtueshme							
Fikse	-	7,348	-	-	-	7,348	78
Depozitat me afat me bankat	2,296	4,593	-	-	-	6,889	12
Kreditë dhe paradhëniet për klientët							
Fikse	10	1,872	155	141	266	2,444	4
Aktive të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	1,266
Totali i aktiveve	8,444	13,813	155	141	266	22,819	3,299
Llogaritë rrjedhëse nga klientët	1,335	891	1,068	2,137	3,472	8,903	16,305
Depozita nga klientët	2	100	142	-	-	244	1
Detyrime të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-
Totali i detyrimeve	1,337	991	1,210	2,137	3,472	9,147	16,306
Hendeku i ndjeshmërisë së normës së interesit - pozicioni i hapur	7,107	12,822	(1,055)	(1,996)	(3,206)	13,672	n/a

Analizat dhe përllogaritjet bëhen për të përcaktuar ndikimin nga lëvizjet e normave të interesit në vlerat ekonomike të kapitalit dhe kapacitetin për të fituar përgjatë një periudhe kohe dhe si pasojë për t'i zvogëluar rreziqet me ndikime mbi këto dy parametra.

Duke marrë parasysh strukturat e aktiveve dhe detyrimeve në EUR dhe USD, më 31 dhjetor 2016 dhe 2015, dhe duke supozuar një zhvendosje paralele të normës së interesit për +/-200 pikë, në aktivet dhe detyrimet me ndjeshmëri ndaj normave profili i rrezikut ndaj normës së interesit të bankës paraqitet më poshtë, ku shifrat negative përfaqësojnë humbje:

Rritja e normës së interesit me 2% Aktivet dhe detyrimet:	Rënie e interesit të fituar gjatë 3 muajve në vazhdim		Rënie e interesit të fituar për një vit në vazhdim		Ndikimi i vlerës ekonomike	
	2016	2015	2016	2015	2016	2015
EUR	491	183	3,794	2,124	(6,133)	(6,129)
USD	41	51	232	346	(79)	167

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku kur banka nuk do të jetë më në gjendje t'i përmbushë obligimet e saj të tanishme dhe të ardhshme në pagesa të plota apo në kohë. Prandaj banka duhet të mbajë në të gjitha kohët fonde të mjaftueshme likuide në dispozicion për t'i plotësuar obligimet e saj, madje edhe në kushte të rrethanave potenciale të jashtëzakonshme. Rreziku i likuiditetit është gjithashtu rreziku që financimi shtesë nuk mund të sigurohet më ose mund të sigurohet vetëm me norma të rritura të interesit. Mund të shkaktohet nga pengesat në treg ose përkeqësimet e kredive, të cilat mund të shkaktojnë që disa burime të caktuara të financimit të bëhen jo të disponueshme. Për të zbutur rrezikun e likuiditetit banka diversifikon burimet e financimit dhe menaxhon aktivet likuide me kujdes, duke mbajtur një bilanc të parasë së gatshme dhe të ekuivalentëve të parasë së gatshme, që janë të mjaftueshme për t'i përmbushur menjëherë detyrimet e kërkuara.

Tabela më poshtë paraqet analizën e likuiditetit sipas maturiteteve të mbetura kontraktuale në datën e raportimit, si dhe sipas maturiteteve të pritura të të dhënave financiare. Shumat e shpallura në pjesën e parë të tabelës janë rrjedha të zbritura kontraktuale të parasë së gatshme. Sidoqoftë, banka menaxhon rrezikun e trashëguar të likuiditetit duke u bazuar në të hyrat dhe në të dalat e parasë së gatshme, siç raportohet në pjesën e dytë. Në transformimin e detyrimeve nga ato të kontraktuara në të pritura, Banka konsideron dy paketa të supozimeve: supozimet të cilat janë rekomanduar nga "ProCredit Holding" dhe të cilat janë bazuar në rregulloret gjermane të likuiditetit, dhe supozimet të cilat dalin nga analiza historike e depozitave të klientëve dhe modelet e tyre të tërheqjes.

Banka synon në të gjitha kohët për të mbajtur pozitiv hendekun kumulativ të maturitetit të pritur. Nëse hendeku i pritur i maturitetit kumulativ nuk do të

jetë pozitiv, banka konsideron që profili i likuiditetit është në një "pozitë vëzhguese të likuiditetit".

Shifrat e raportuara me mjetin raportues më poshtë nuk përkojnë me shifrat në pasqyrën e pozicionit financiar dhe kjo për shkak të faktit se përveç pozitive të bilancit, banka ka marrë parasysh pozitave të bilancit, banka ka marrë parasysh pozitave të bilancit gjithashtu. Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare janë raportuar duke u bazuar në kohën kur detyrimet (duke përfshirë detyrimet kontingjente nga garancitë bankare, letrat e kredive dhe zotimet e tjera të lidhura me kreditë) bëhen të pagueshme dhe aktivet mund të përdoren si burime të pagesës (duke përfshirë zërat jashtë bilancit, siç janë zotimet e kredive të patërhequra dhe të pakushtëzuara, të cilat banka mund t'i përdorë si burime likuiditeti në çfarëdo kohe pa aprovim paraprak).

Në tabelën e hendekut të likuiditetit më poshtë përcaktimet në vijim janë konsideruar si të rëndësishme:

- Aktivet 1 - janë aktivet të cilat nuk kanë maturitet kontraktual dhe/ose mund të konvertohen në para të gatshme shumë shpejt,
- Aktivet 1-S – janë aktivet që kanë maturitet kontraktual dhe shpërndahen, duke u bazuar në maturitetet mbetëse,
- Detyrimet 1 – janë detyrimet të cilat në mënyrë kontraktuale janë detyrime me kërkesë,
- Detyrimet 1-S – janë detyrimet që kanë maturitet kontraktual dhe të cilat shpërndahen në periudha kohore, duke u bazuar në maturitetet e mbetura.

**5. Menaxhimi i rrezikut financiar
(vazhdim)
(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	> 1 vit	Totali
Deri, më 31 dhjetor 2016						
Aktive 1						
Para të gatshme	55,984	-	-	-	-	55,984
Rezervat me Bankën Qendrore	37,610	-	-	-	-	37,610
Llogaritë rrjedhëse me Bankën Qendrore	27,670	-	-	-	-	27,670
Llogaritë rrjedhëse me bankat	28,985	-	-	-	-	28,985
Zotimet e papërdorura të kredisë	-	-	-	-	-	-
Bono thesari dhe letrat me vlerë të tregtueshme	30,000	6,247	9,660	26,377	57,893	130,177
Aktivët 1-S						
Depozitat me afat me bankat	12,261	22,131	-	2,406	1,250	38,048
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	24,315	38,437	62,797	112,825	292,552	530,926
Aktivët totale	216,825	66,815	72,457	141,608	351,695	849,400
Detyrimet kontraktuale						
Detyrimet 1						
Detyrimet ndaj bankave (detyrimet ditore)	128	-	-	-	-	128
Detyrimet ndaj klientëve (detyrimet ditore)	605,178	-	-	-	-	605,178
Detyrimet kushtëzuese nga garancitë	27,086	-	-	-	-	27,086
Angazhime të papërdorura të kredisë	61,280	-	-	-	-	61,280
Detyrimet 1-S						
Detyrimet ndaj klientëve	7,765	8,916	13,699	31,238	22,715	84,333
Borxhi i varur	-	263	-	397	21,673	22,333
Detyrimet totale kontraktuale	701,437	9,179	13,699	31,635	44,388	800,338
Hendeku periodik kontraktual i likuiditetit	(484,612)	57,636	58,758	109,973	307,307	49,062
Hendeku kumulativ kontraktual i likuiditetit	(484,612)	(426,976)	(368,218)	(258,245)	49,062	-
Detyrimet e pritura						
Detyrimet 1						
Detyrimet ndaj bankave (detyrimet ditore)	64	-	-	-	-	64
Detyrimet ndaj klientëve (detyrimet ditore)	41,055	11,802	17,511	10,904	523,907	605,178
Detyrimet kushtëzuese nga garancitë	-	-	-	-	-	-
Zotimet e papërdorura të kredisë	1,354	-	-	-	-	1,354
Detyrimet ndaj bankave (detyrimet ditore)	6,128	-	-	-	-	6,128
Detyrimet 1-S						
Detyrimet ndaj klientëve	7,765	8,916	13,699	31,238	22,715	84,333
Borxhi i varur	-	263	-	397	21,673	22,333
Detyrimet totale të pritura	56,366	20,981	31,210	42,539	568,295	719,391
Hendeku periodik kontraktual i likuiditetit	160,458	45,834	41,248	99,069	(216,600)	130,009
Hendeku kumulativ kontraktual i likuiditetit	160,458	206,292	247,540	346,609	130,009	-

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim) (c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

	Deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	> 1 vit	Totali
Deri, më 31 dhjetor 2015						
Aktive 1						
Para të gatshme	84,936	-	-	-	-	84,936
Rezervat me Bankën Qendrore	24,678	-	-	-	-	24,678
Llogaritë rrjedhëse me Bankën Qendrore	55,194	-	-	-	-	55,194
Llogaritë rrjedhëse me bankat	26,113	-	-	-	-	26,113
Zotimet e papërdorura të kredisë	17,000	-	-	-	-	17,000
Bono thesari dhe letrat me vlerë të tregtueshme	2,006	11,244	9,901	21,484	42,656	87,291
Aktive 1-S						
Depozitat me afat me bankat	23,201	32,544	-	-	-	55,745
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	26,102	38,178	57,652	110,009	295,144	527,085
Totali i aktiveve	259,230	81,966	67,553	131,493	337,800	878,042
Detyrimet kontraktuale						
Detyrimet 1						
Detyrimet ndaj bankave (detyrimet ditore)	249	-	-	-	-	249
Detyrimet ndaj klientëve (detyrimet ditore)	570,130	-	-	-	-	570,130
Detyrimet kushtëzuese nga garancitë	29,645	-	-	-	-	29,645
Zotimet e papërdorura të kredisë	55,946	-	-	-	-	55,946
Detyrimet 1-S	9,833	12,379	16,216	41,138	30,151	109,717
Detyrimet ndaj klientëve	-	263	25	327	20,266	20,881
Totali i detyrimeve kontraktuale	665,803	12,642	16,241	41,465	50,417	786,568
Hendeku periodik kontraktual i likuiditetit	(406,573)	69,324	51,312	90,028	287,383	91,474
Hendeku kumulativ kontraktual i likuiditetit	(406,573)	(337,249)	(285,937)	(195,909)	91,474	-
Detyrimet e pritura						
Detyrimet 1						
Detyrimet ndaj bankave (detyrimet ditore)	124	125	-	-	-	249
Detyrimet ndaj klientëve (detyrimet ditore)	85,780	23,030	34,172	68,344	358,804	570,130
Detyrimet kushtëzuese nga garancitë	1,482	-	-	-	-	1,482
Zotimet e papërdorura të kredisë	11,189	-	-	-	-	11,189
Detyrimet 1-S	9,833	12,379	16,216	41,138	30,151	109,717
Borxhi i varur	-	263	25	327	20,266	20,881
Totali i detyrimeve të pritura	108,408	35,797	50,413	109,809	409,221	713,648
Hendeku periodik kontraktual i likuiditetit	150,822	46,169	17,140	21,684	(71,421)	164,394
Hendeku kumulativ kontraktual i likuiditetit	150,822	196,991	214,131	235,815	164,394	-

Për qëllime likuiditeti, Banka klasifikon depozitat me kërkesë dhe depozitat e kursimit si obligim me kërkesë, duke i raportuar në periudhën kohore të maturitetit deri në 1 muaj. Kjo çon në hendeqe të larta kontraktuale të likuiditetit për periudhat kohore deri në 12 muaj. Sidoqoftë, mundësia që shuma shumë të mëdha të depozitave të klientëve do të tërhiqeshin është shumë e vogël. Prandaj, banka nuk e konsideron si afatshkurtër hendekun e likuiditetit, duke u fokusuar në hendekun e pritur të maturitetit, që paraqet një pikëpamje më të mundshme.

Banka ruan një portofol të aktiveve të tregtueshme financiare (Aktiveve financiare VPS), të cilat lehtas mund të likuidohen si mbrojtje kundër ndërprerjeve të paparashikuara në rrjedhën e parasë së gatshme. Menaxhimi i bankës monitoron normat e likuiditetit kundrejt kërkesave të brendshme dhe rregullatore në baza ditore, javore dhe mujore. Si rezultat, menaxhmenti beson që banka nuk ka hendek afatshkurtër të likuiditetit. Gjatë vitit 2016 banka ka aplikuar teste stresi të likuiditetit në baza mujore për të gjitha valutat operative dhe ka diskutuar për këtë në mënyrë të rregullt në Komitetin e Menaxhimit të Rrezikut dhe ALCO-në. Testi i stresit

kryhet për tre skenarë të ndryshëm sipas Politikës së Menaxhimit të Rrezikut të Likuiditetit, nga ato më pak konservatore deri te skenarët më konservatorë. Nëse bordi menaxhues dhe Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut sheh ndonjë vështirësi në këta skenarë, ata ndërmarrin hapat e nevojshëm për të minimizuar ndonjë rrezik.

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Menaxhimi i kapitalit

Objektivat e bankës për menaxhim të kapitalit janë: (I) të jetë në përputhje me kërkesat e kapitalit të caktuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK); (II) të mbrojë aftësinë e bankës për të vazhduar në vijimësi, që ajo të vazhdojë të ofrojë kthime për aksionarët dhe benefite për aksionarët e tjerë, dhe (III) të ruajë një bazë të fuqishme të kapitalit për të mbështetur zhvillimin e biznesit të saj.

Mjaftueshmëria e kapitalit dhe përdorimi i kapitalit rregullator janë monitoruar në baza mujore nga menaxhmenti i bankës duke angazhuar teknika, të bazuar në udhëzimet e BQK-së. Informatat e kërkuara janë ofruar tek BQK-ja në baza tremujore.

Aktivitet me peshë rreziku (APR) janë matur përmes një hierarkie prej pesë nivelesh të rrezikut, klasifikuar sipas natyrës së tyre dhe duke reflektuar një llogaritje të kredisë, tregut dhe rreziqeve të tjera të lidhura me secilin aktiv dhe për ekspozimet jashtë bilancit, me disa përshtatje për të reflektuar natyrën kushtëzuese të humbjeve potenciale.

BQK-ja kërkon nga banka që të mbajë një nivel minimal të kapitalit rregullator prej 7,000 mijë eurosh, për të mbajtur një normë të kapitalit me aktivet me peshë të rrezikut Klasa I ('Norma Bazel') në ose mbi minimumin e 8% (Aktuale 2016: 15.04%) dhe për të ruajtur kapitalin total rregullator, Klasa II, Aktivitet me peshë të madhe në ose mbi minimumin 12% (Aktuale 2016: 17.52%). Prandaj, duke u bazuar në normat gjegjëse banka ishte në pajtueshmëri me kërkesat për mjaftueshmëri të kapitalit në datën e raportimit.

Deri më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 normat e mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës në pajtim me rregulloret e BQK-së janë:

	2016	2015
Kapitali i Klasës I		
Kapitali aksionar dhe primi i aksionit	65,550	65,550
Rezervat	511	511
Fitimet e mbajtura ¹	22,109	32,225
Minus: Aktivitet e patrupëzuara	(152)	(581)
Minus: Kreditë për personat e lidhur me bankën	(4,538)	(5,812)
Minus: Aktivitet për tatimet e shtyra	-	(116)
Kapitali total kualifikues i Klasës I	83,480	91,777
Kapitali i Klasës II		
Detyrimi i varur	7,500	7,500
Provizionet për humbjet e kredive (të kufizuara në 1.25% të APR-së)	6,235	6,216
Kapitali total kualifikues i Klasës II	13,735	13,716
Kapitali total rregullator	97,215	105,493
Aktivitet me peshë rreziku:		
Në bilancin e gjendjes	479,883	470,436
Jashtë bilancit të gjendjes	18,900	26,865
Aktivitet për rrezik operativ	56,106	59,964
Aktivitet totale me peshë rreziku	554,889	557,265
Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të Klasës I	15.04%	16.47%
Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të Klasës II	17.52%	18.93%

¹Fitimet e mbajtura për kapitalin e Klasës 1 bazohen në pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me metodologjinë për raportim të Bankës Qendrore të Kosovës.

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Kapaciteti për bartjen e rrezikut

Përveç normave rregullatore të kapitalit, banka vlerëson mjaftueshmërinë e kapitalit të saj duke përdorur konceptin e kapacitetit të bartjes së rrezikut për të reflektuar profilin specifik të rrezikut të bankës, d.m.th. krahasimin e humbjeve potenciale nga operacionet e saj me kapacitetin e bankës për të'i mbartur humbjet e tilla. Konceptet në vijim janë përdorur për të llogaritur humbjet potenciale në kategori të ndryshme të rrezikut.

- Rreziku kreditor (klientët): Norma e humbjeve historike dhe shpërndarja e tyre statistikore janë llogaritur duke u bazuar në analizën e përditësuar rregullisht të portofolit të kredive. Normat e humbjeve historike në kategoritë e vonesave të ndryshme (në nivel besimi 95%) aplikohen për portofolin e kredive për t'i llogaritur humbjet potenciale nga kreditë.
- Rreziku (palës tjetër): Llogaritja e humbjeve potenciale për shkak të rrezikut të palës tjetër është bazuar në probabilitetin e mospagesave, që paraqiten nga kategorizimi ndërkombëtar përkatës i palës homologe ose shtetit të saj përkatës të operimit (pas rregullimit).
- Rreziku i tregut: Derisa lëvizjet historike të valutës analizohen në mënyrë statistikore dhe variancat më të larta (nivel besimi 99%) aplikohen për pozitat e tanishme të valutës, rreziku i normës së interesit llogaritet duke përcaktuar ndikimin e vlerës ekonomike të tronditjes së normës standarde të interesit për EUR/USD (2 për qind pikë, tronditja e normës së interesit të Bazel-it) dhe niveleve më të larta të tronditjes për valutat e tjera.
- Rreziku operativ: Qasja e standardit Bazel II përdoret për të kalkuluar vlerën përkatëse.

Banka ka treguar një nivel modest të përdorimit të BDMRR-së së saj deri më 31 dhjetor 2016. Përdorimi i limitit të rrezikut homolog dhe të tregut ishte sërish i ulët, duke reflektuar qasjen kundërshtuese të menaxhimit ndaj rrezikut, që udhëheq operacionet e thesarit të bankës.

Kapitali ekonomik i kërkuar për mbulimin e rrezikut operativ është llogaritur sipas qasjes standarde Bazel II. Të dhënat e mbledhura gjatë vitit 2013 në Bazën e të Dhënave të Ngjarjeve të Rrezikut (RED), e cila regjistron të dhënat e ngjarjeve të rrezikut në shkallë të bankës dhe anëmbanë grupit, tregon nivel të ulët të rrezikut operativ. Të gjitha rreziqet e

kombinuara, të kuantifikuara përmes metodave të përcaktuara në politikat e bankës ishin konsiderueshëm nën 60% të kapacitetit total të bartjes së rrezikut.

6. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Vlera e drejtë e aktiveve dhe e detyrimeve financiare të tregtuara në tregje aktive bazohet në çmime të kuotuar të tregut ose në kuotime të tregtarëve. Banka vendos vlerat e drejta për instrumentet financiare, duke përdorur metodologjitë e duhura të vlerësimit.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të tregtuara joshpesh ka më pak transparencë çmimi, pra vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon gjykim në nivele të ndryshme, të cilat varen nga likuiditeti, përqendrimi, pasiguritë e faktorëve në treg, supozimet e çmimit dhe rreziqe të tjera që ndikojnë në një instrument financiar specifik.

(a) Modelet e vlerësimit

Banka mat vlerat e drejta duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë, e cila reflekton rëndësinë e të dhënave të përdorura në kryerjen e matjeve.

Niveli 1: Inputet janë çmimet e tregut të kuotuar (të parregulluara) në tregje aktive për instrumente identike.

Niveli 2: Inputeve të tjera përveç çmimeve të kuotuar të përfshira në Nivelin 1, që janë të observueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë (si çmimet) ose të tërthortë (p.sh. rrjedhin nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar duke përdorur: çmimet e kuotuar në tregjet aktive për instrumente të ngjashme; çmimet e kuotuar për instrumente identike ose të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak aktive; ose teknika vlerësimi ku të gjithë inputet e rëndësishme janë direkt ose indirekt të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.

Niveli 3: Inputet janë jo të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin gjithë instrumentet për të cilat metoda e vlerësimit përfshin inpute që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe të dhënat jo të vëzhgueshme kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente, të cilat janë vlerësuar në bazë të çmimeve të kuotuar për instrumente të ngjashme për të cilat kërkohen rregullime të rëndësishme, jo të

vëzhgueshme ose supozime për të reflektuar ndryshimin midis instrumenteve.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e zbritura të flukseve të parave, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime tregu të vëzhgueshme dhe metoda të tjera.

6. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

(a) Modelet e vlerësimit (vazhdim)

Supozimet dhe inputet e përdorura në metodat e vlerësimit përfshijnë normat e interesit pa rrezik në treg, normat e kredisë dhe prime të tjera të përdorura në llogaritjen e normave të zbritura, çmimet e kapitalit, normat e këmbimit në valutë të huaj, çmimet e kapitalit e të indeksit të kapitalit dhe luhatjet e pritshme të çmimeve dhe korrelacionet. Objektivi i teknikave të vlerësimit është të arrijë në matjen e vlerës së drejtë, e cila reflekton çmimin që do të marrë për ta shitur aktivin ose për të paguar për transferimin e detyrimit në një transaksion të rregullt mes pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Banka përdor modele të njohura gjerësisht të vlerësimit për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve më të zakonshme dhe më të thjeshta, të tilla si norma e interesit dhe këmbime të valutës që përdorin vetëm të dhëna të publikuara tregu dhe që kërkojnë pak gjykim e vlerësim. Çmimet e vëzhgueshme ose inputet model janë zakonisht në dispozicion në treg për borxhin e listuar dhe letrat me vlerë të kapitalit. Disponueshmëria e çmimeve të publikuara në bursë të vëzhgueshme redukton nevojën për gjykim e vlerësim dhe redukton

pasigurinë e shoqëruar me përcaktimin e vlerave të drejta. Disponueshmëria e çmimeve të vëzhgueshme në bursë dhe e faktorëve ndryshon në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është e prirë që të ndryshojë në bazë të ngjarjeve të veçanta dhe kushteve të përgjithshme të tregjeve financiare.

Vlerësimet e vlerave reale të përfuara nga modelet rregullohen për faktorë të tjerë, të tillë si rreziku i likuiditetit ose pasiguritë e modelit, deri në atë masë sa banka beson se një pjesëmarrës në treg si palë e tretë do t'i marrë ato parasysht në vendosjen e çmimit të një transaksioni. Vlera e drejtë reflekton rrezikun e kredihënies së instrumenteve dhe përfshin rregullime për të marrë parasysht rrezikun e kredisë së bankës dhe të palëve të tjera kur është e përshtatshme.

Inputet dhe vlerat e modelit kalibrohen ndaj të dhënave historike dhe parashikimeve të publikuara dhe, kur është e mundur, kundrejt transaksioneve aktuale ose të fundit të vëzhguara për instrumente të ndryshme dhe kundrejt kuotimeve të tregtarëve. Ky proces kalibrimi është prej natyre subjektiv dhe jep një segment inputesh të mundshme dhe vlerësimesh të vlerës së drejtë dhe gjykimi i menaxhimit është i nevojshëm për ta zgjedhur pikën më të përshtatshme në segment.

(b) Instrumentet financiare të matura me vlerë të drejtë

Tabela e mëposhtme analizon instrumentet financiare të matura në vlerën e drejtë në datën e raportimit sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë, në të cilën kategorizohet matja e vlerës së drejtë. Këto vlera janë njohur në pasqyrën e pozicionit:

Aktivitet financiarë të vlefshme për shitje (borxh)	Totali i vlerës së drejtë	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
31 dhjetor 2016	131,309	106,777	24,532	-
Sigurime	114,896	106,777	8,119	-
Bono thesari	16,413	-	16,413	-
31 dhjetor 2015	87,954	63,654	24,300	-
Sigurime	71,345	63,654	7,691	-
Bono thesari	16,609	-	16,609	-

6. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare (Vazhdim)

(c) Instrumentet financiare jo të matura me vlerën e drejtë

Tabela e mëposhtme përcakton vlerat e drejta të instrumenteve financiare që nuk maten me vlerën e drejtë dhe analizon ato sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë në të cilën çdo matje me vlerën e drejtë është kategorizuar.

	31 dhjetor 2016			31 dhjetor 2015		
	Vlera e mbartur	Vlera e drejtë Nivel 2	Vlera e drejtë Nivel 3	Vlera e mbartur	Vlera e drejtë Nivel 2	Vlera e drejtë Nivel 3
Aktivt financiare						
Kreditë dhe të arketueshmet						
Para dhe gjendja me Bankën Qendrore	121,264	121,264	-	164,808	164,808	-
Kredi dhe paradhënie për bankat	67,004	67,004	-	81,861	81,861	-
Llogari rrjedhëse	33,016	33,016	-	26,113	26,113	-
Depozitat me afat në banka	33,988	33,988	-	55,748	55,748	-
Kreditë dhe paradhënie për klientët	452,514	-	441,295	436,730	-	424,263
Kredi fikse	327,322	-	315,972	343,946	-	331,390
Kredi bujqësore	29,732	-	29,344	35,357	-	34,055
Kredi biznesi	201,614	-	194,734	203,510	-	194,626
Kredi private	9,523	-	9,144	7,075	-	6,962
Kredi për banim	86,453	-	82,750	98,004	-	95,747
Kredi të tjera	125,192	-	125,323	92,784	-	92,873
Aktive të tjera financiare	5,112	5,112	-	1,941	1,941	-
Detyrime financiare						
Detyrime ndaj bankave	227	227	-	249	249	-
Detyrime ndaj klientëve	688,843	612,638	75,957	678,057	576,922	100,753
Llogari rrjedhëse	407,149	407,149	-	365,698	365,698	-
Llogari të kursimeve	195,234	195,234	-	209,041	209,041	-
Depozita me afat	76,205	-	75,957	101,135	-	100,753
Llogari të tjera për klientët	10,255	10,255	-	2,183	2,183	-
Huazime dhe borxhi i varur	17,679	-	17,452	15,668	-	15,360
Huazime	10,034	-	9,807	8,021	-	7,713
Borxhe të varura	7,645	-	7,645	7,647	-	7,647
Detyrime të tjera financiare	1,385	1,385	-	1,267	1,267	-

Kur është e mundur, vlera e drejtë e kredive dhe e paradhënies është e bazuar në transaksionet e tregut të vëzhgueshëm. Kur transaksione tregu të vëzhgueshëm nuk janë në dispozicion vlera e drejtë është llogaritur duke përdorur metoda të vlerësimit, të tilla si teknikat e zbritjes së rrjedhës së parasë. Inputet në teknikat e vlerësimit përfshijnë humbjet e pritshme të kredisë gjatë gjithë jetës, normat e interesit dhe normat e parapagimit.

Për kreditë e zhvlerësuara, të cilat varen prej kolateraleve, vlera e drejtë matet duke u bazuar në vlerën e kolateralit përkatës. Për të përmirësuar saktësinë e vlerësimit të kredive individuale dhe të vogla tregtare kreditë homogjene janë të grupuara në portofol me karakteristika të ngjashme.

Vlera e drejtë e depozitave nga bankat dhe klientët llogaritet duke përdorur teknikën e zbritjes së rrjedhës së parasë, duke aplikuar normat që janë të ofruara për depozitat me maturitete dhe kushte të ngjashme. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme kur kërkohen është shuma për t'u paguar në datën e raportimit.

7. Të ardhurat neto nga interesi

	2016	2015
Të ardhurat nga interesi		
Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve	39,160	45,603
Kreditë dhe paradhëniet ndaj bankave	284	387
Aktivitet financiarë të vlefshme për shitje	(460)	7
Të tjera	132	86
Totali i të ardhurave nga interesi	39,116	46,083
Shpenzime interesi		
Detyrime ndaj klientëve	1,021	1,998
Fondet e huazuara	654	973
Të tjera	128	153
Totali i shpenzimeve të interesit	1,803	3,124
Të ardhurat neto nga interesi	37,313	42,959

Të ardhurat nga interesi i kredive dhe avancave të klientëve për vitin e mbyllur, më 31 dhjetor 2016, përfshin 469 mijë euro (2015: 731 mijë euro) dhe

1,194 mijë euro (2015: 1,628 mijë euro) që lidhen me interesin aktual dhe aktive financiare të zhvlerësuar dhe efektin kohor të zbritjes së huave dhe avancave të zhvlerësuar tek klientët.

8. Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet

	2016	2015
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet		
Transferet dhe transaksionet e pagesave	4,075	4,594
Kartat e debitit dhe të kreditit	2,755	2,665
Tarifat e mirëmbajtjes së llogarisë	1,321	1,260
Letrat e kredisë dhe garancitë	732	1,179
Tarifa dhe komisione të tjera	726	797
Totali i të ardhurave nga tarifat dhe komisionet	9,609	10,495
Shpenzimet nga tarifat dhe komisionet		
Ofruesi i TI-së dhe shërbimet përkatëse	1,281	1,242
Tarifat dhe komisionet ndaj llogarive bankare	606	525
Tarifat e tjera ndaj bankave	860	507
Tarifat dhe shpenzimet e lidhura me kartat	602	444
Tarifat nga transaksione me pale të treta	1,322	1,006
Tarifa të tjera	272	301
Totali i shpenzimeve nga tarifat dhe komisionet	4,943	4,025
Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet	4,666	6,470

9. Shpenzimet administrative dhe të tjera operative

	2016	2015
Shpenzime personeli (shih më poshtë)	7,426	9,728
Zhvlerësim dhe amortizim (shih shënimin 15 dhe 16)	3,221	2,944
Shpenzime të tjera	2,281	2,434
Shpenzime qiraje	1,826	2,080
Mirëmbajtje dhe riparime	1,785	1,519
Tarifa ligjore dhe konsulence	1,537	1,118
Shpenzime për fondin e sigurimit të depozitave	1,116	752
Shpenzime trajnimi	831	759
Shpenzime për "ProCredit Holding" dhe akademitë	735	778
Shpenzime reklame dhe promocionale	529	866
Shërbime komunale	509	757
Shërbime sigurie	505	626
Komunikim (telefon, lidhje rrjeti)	460	605
Të drejta përdorimi për softuerët	399	379
Furnizime për zyrë	257	229
Sistemimi i pronës dhe i pajisjeve	206	1,513
Transport (karburant, mirëmbajtje)	200	319
Provizione për garancitë e dhëna	120	199
	23,943	27,605

Më 31 dhjetor 2016, banka punësoi 465 punonjës (2015: 544 punonjës).

	2016	2015
Rrogat dhe pagat	6,618	8,000
Kontributi pensional	335	397
Përfitimet dytësore	111	160
Kompensime të tjera	362	1,171
	7,426	9,728

10. Shpenzimet e tatim-fitimit

(a) Shumat e njohura në fitim ose në humbje

	2016	2015
Tatimi në fitimin e vitit	980	2,956
Të ardhurat nga tatimi i shtyrë	798	(743)
Shpenzimet e tatimit në fitim	1,778	2,213

Tatimi mbi fitimin llogaritet duke u bazuar në rregulloret e Tatimit mbi Fitimin, të zbatueshme në Kosovë, duke përdorur normat në fuqi të tatimit në

datën raportuese. Norma e tatimit për të ardhurat e korporatës është 10% (2015: 10%)

b) Shumat e njohura në të ardhurat e tjera përmbledhëse (ATP)

	2016			2015		
	Para tatimit	Përfitimi tatimor	Neto nga tatimi	Para tatimit	Shpenzimi tatimor	Neto nga tatimi
Investimet e vlefshme për shitje	254	(25)	229	64	(6)	58
Totali (shih shënimin 24)	254	(25)	229	64	(6)	58

10. Tatimi në fitim (vazhdim)

(c) Barazimi i normës efektive tatimore

Më poshtë paraqitet barazimi i tatimeve të përllogarit me normën e zbatueshme prej 10% (2015:10%) me shpenzimin aktual tatimor:

	2016	2015
Fitimi para tatimit	17,837	20,583
Tatimi me normën tatimore të korporatave	1,784	2,058
Të ardhura të përjashtuara	(144)	(68)
Shpenzimet e pazbritshme tatimore	138	223
	1,778	2,213

Tatim-fitimi i parapaguar deri më 31 dhjetor 2016 është 2,138 mijë euro (31 dhjetor 2015:EUR 330 mijë)

(d) Lëvizjet në gjendjet e tatimit të shtyrë

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke u bazuar në normën e miratuar prej 10% (2015: 10%)

	2016	itimi ose humbja	ATP	2015	Fitimi ose humbja	ATP	2014
Aktivët e tatimit të shtyrë							
Interesi i përllogarit për kreditë	-	-	-	-	-	-	-
Investimet e vlefshme për shitje	-	-	(1)	2	-	(6)	8
Interesi i përllogarit për depozitat	52	(47)	-	99	(77)	-	176
Zhvlerësimi për pasuri dhe pajisje	-	(17)	-	17	20	-	(3)
Provizione për zhvlerësimin e kredive	-	(496)	-	496	759	-	(263)
	52	(560)	(1)	614	702	(6)	(82)
Detyrim-tatimi i shtyrë							
Interesi i përllogarit për kreditë	(46)	24	-	(70)	41	-	(111)
Investimet e vlefshme për shitje	(25)	-	(25)	-	-	-	-
Interesi i përllogarit për depozitat	-	-	-	-	-	-	-
Zhvlerësimi për pasuri dhe pajisje	(49)	(49)	-	-	-	-	-
Provizione për zhvlerësimin e kredive	(212)	(212)	-	-	-	-	-
	(332)	(237)	(25)	(70)	41	-	(111)
Detyrimi i tatimit të shtyrë neto	(280)	(797)	(26)	544	743	(6)	(193)

11. Paraja e gatshme dhe gjendja me bankat qendrore

	2016	2015
Paraja e gatshme	55,984	84,936
Letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës (me maturitet deri në 3 muaj ose më pak)	3,000	250
Shumat e mbajtura në BQK		
Llogaritë rrjedhëse	7,309	52,546
Rezerva e detyrueshme	37,610	24,678
Gjendja me "Deutsche Bundesbank"	17,361	2,398
	121,264	164,808

Në përputhje me kërkesat e BQK-së lidhur me depozitat minimale rezervë, që duhen mbajtur për qëllime likuiditeti, banka mban minimumin e kërkuar prej 10% të depozitave të klientëve të saj me maturitet deri në një vit si rezervë të detyrueshme.

Rezerva e detyrueshme përfaqëson instrumente me likuiditet të lartë që përfshijnë paratë e gatshme,

llogaritë me BQK-në ose banka të tjera në Kosovë, dhe shumat e mbajtura në BQK nuk duhet të jenë më pak se gjysma e totalit [shih 5 (d)] të rezervës së detyrueshme. Për kategorizime referohuni shënim-it 5 (a)(i).

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqiten si vijon:

	2016	2015
Paraja e gatshme dhe gjendja me bankat qendrore	121,264	164,808
Rezerva e detyrueshme	(37,610)	(24,678)
Kreditë dhe paradhëniet me bankat me maturitet tre muaj ose më pak (shënimi 12)	63,346	81,852
	147,000	221,982

12. Kredi dhe paradhënie për bankat

	2016	2015
Llogaritë rrjedhëse 47	33,016	26,113
Depozitat me afat në banka	33,988	55,748
	67,004	81,861

Normat e interesit vjetor mbi depozitat me afat në banka në fund të periudhës raportuese ishin si në vijim:

- Depozitat në EUR: nga (0,38)% deri 0.07 % p.v.(2015: nga (0.15)% to 0.07% p.v.); dhe
- Depozitat në USD: nga 0.42% deri 1.05% p.v. (2015: nga 0.42% to 0.40% p.v.).

13. Kredi dhe paradhënie për klientët

	2016	2015
Kreditë për klientët	427,635	413,989
Mbitërheqjet	46,695	47,783
Kartat e kreditit të arkëtueshme	686	798
	475,016	462,570
Fondi i zhvlerësimit për humbjet nga kreditë	(22,502)	(25,840)
	452,514	436,730

	2016			2015		
	Shuma bruto	Fondi i zhvlerësimit	Shuma neto	Shuma bruto	Fondi i zhvlerësimit	Shuma neto
Klientët individualë:						
Mbitërheqjet	2,154	(291)	1,863	3,030	(690)	2,340
Kartat e kreditit	686	(72)	614	796	(90)	706
Kredi private	10,279	(285)	9,994	7,823	(247)	7,576
Përmirësimi i shtëpive	120,914	(4,559)	116,355	118,321	(4,724)	113,597
Klientët korporata:						
Mbitërheqjet	44,529	(1,584)	42,945	44,696	(1,407)	43,289
Deri në 150 mijë euro	160,937	(11,036)	149,901	166,633	(12,982)	153,651
Mbi 150 mijë euro	135,517	(4,675)	130,842	121,271	(5,700)	115,571
	475,016	(22,502)	452,514	462,570	(25,840)	436,730

Cilësia e kredive dhe e avancave pa vonesa dhe të pazhvlërësuar të dhëna klientëve janë paraqitur në vijim:

31 dhjetor 2016	Privat	Biznesi	Totali
Pa vonesa dhe të pazhvlërësuar			
Kredimarrësit ekzistues me rëndësi	8,164	234,617	242,781
Kredimarrësit e rinj me rëndësi	6,612	45,288	51,900
Kredimarrësit të tjerë me më pak se 30 mijë euro	114,823	30,575	145,398
	129,599	310,480	440,079

31 dhjetor 2015	Privat	Biznesi	Total
Pa vonesa dhe të pazhvlërësuar			
Kredimarrësit ekzistues me rëndësi	6,555	196,892	203,447
Kredimarrësit e rinj me rëndësi	3,943	53,145	57,088
Kredimarrësit të tjerë me më pak se 30 mijë euro	112,039	46,826	158,865
	122,537	296,863	419,400

Kredimarrësit me rëndësi i referohet disbursimit të kredive në shuma më të mëdha se 30 mijë euro.

Lëvizjet në lejimet për zhvlërësime për humbjet e kredive më 31 dhjetor 2016 ishin si në vijim:

	2016			2015		
	Biznesi	Privat	Totali	Biznesi	Privat	Totali
Më 1 janar	18,543	7,297	25,840	27,516	3,798	31,314
Ngarkesa për vitin	1,786	14	1,800	641	2,502	3,143
Efekt i kohor i zbritjes	(1,139)	(57)	(1,196)	(1,598)	(29)	(1,627)
Kreditë e fshira	(3,559)	(383)	(3,942)	(7,209)	219	(6,990)
Më 31 dhjetor	15,631	6,871	22,502	19,350	7,297	25,840

Më 31 dhjetor 2016, portofoli i kredive përfshinte kreditë për punonjësit e bankës në shumën prej 779 mijë eurosh (2015: 1,830 mijë euro). Këto kredi janë

monitoruar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), që përcakton limite maksimale të lejuara për kredi të tilla në raport me kapitalin rregullator të bankës.

14. Aktivet financiare të vlefshme për shitje

	2016	2015
Aksionet në kompanitë e vendosura në shtetet e OECD-së	69	58
Letrat me vlerë të borxhit	131,309	87,954
Totali	131,378	88,012

15. Aktivet e patrupëzuara

	Softueri
Kosto	
Më 1 janar 2015	5,610
Shtesat	635
Largimet nga përdorimi	(4)
Më 31 dhjetor 2015	6,241
Shtesat	421
Largimet nga përdorimi	(155)
Më 31 dhjetor 2016	6,507
Zhvlerësimi i akumuluar	
Më 1 janar 2015	4,801
Shpenzimi për vitin	864
Çregjistrime	(4)
Më 31 dhjetor 2015	5,661
Shpenzimi për vitin	846
Largimet nga përdorimi	(152)
Më 31 dhjetor 2016	6,355
Vlera neto e mbartur	
Më 31 dhjetor 2015	580
Më 31 dhjetor 2016	152

16. Pronat dhe pajisjet

	Toka	Ndërtesat	Aktivet në ndërtim	Mobiljet dhe oren-ditë	Përmirësimet e objekteve me qira	Përmirësimet e objekteve me qira	Totali
Kosto							
Më 1 janar 2015	4,907	6,702	79	1,544	17,628	4,212	35,072
Shtesat	-	-	1,473	111	3,828	-	5,412
Transfertat	-	71	(820)	-	-	749	-
Largimet nga përdorimi	-	(544)	-	(113)	(1,333)	(2,973)	(4,963)
Më 31 dhjetor 2015	4,907	6,229	732	1,542	20,123	1,988	35,521
Shtesat	-	-	1,415	24	1,235	-	2,674
Transfertat	-	38	(642)	-	-	604	-
Largimet nga përdorimi	-	(29)	-	(1,004)	(5,384)	(124)	(6,541)
Më 31 dhjetor 2016	4,907	6,238	1,505	562	15,974	2,468	31,654
Zhvlerësimi i akumuluar							
Më 1 janar 2015	-	2,256	-	1,420	14,190	2,756	20,622
Shpenzimet për vitin	-	340	-	77	1,446	217	2,080
Transfertat	-	-	-	40	(40)	-	-
Largimet nga përdorimi	-	(237)	-	(112)	(790)	(2,139)	(3,278)
Më 31 dhjetor 2015	-	2,359	-	1,425	14,806	834	19,424
Shpenzimet për vitin	-	325	-	69	1,709	271	2,374
Transfertat	-	(1)	-	-	1	-	-
Largimet nga përdorimi	-	(14)	-	(1,000)	(5,384)	(122)	(6,520)
Më 31 dhjetor 2016	-	2,669	-	494	11,132	983	15,278
Vlera neto e mbartur							
Më 31 dhjetor 2015	4,907	3,870	732	117	5,317	1,154	16,097
Më 31 dhjetor 2016	4,907	3,569	1,505	68	4,842	1,485	16,376

17. Aktive të tjera financiare

	2016	2015
Tarifa e përlogaritur e mirëmbajtjes së llogarisë	256	329
Depozitat e sigurisë	593	574
Të arkëtueshme nga institucionet financiare	595	870
Të arkëtueshme nga klientët (nuk lidhen me huazimet)	3,384	127
Aktivet e tjera financiare	284	41
	5,112	1,941

Aktivet e tjera financiare nuk janë as obligim i vonuar e as të zhvlerësuar dhe janë klasifikuar në kategorinë standarde sipas kategorizimit kreditor

të bankës, të arkëtueshme nga klientët lidhur me operimet me para të gatshme.

18. Aktive të tjera

	2016	2015
Shpenzimet e parapaguara	205	180
Llogari shlyerjeje në fundvit	3,763	154
Inventarë dhe paradhënie	1,091	556
	5,059	890

19. Detyrimet ndaj bankave

	2016	2015
Llogaritë rrjedhëse	227	249
	227	249

20. Detyrimet ndaj klientëve

	2016	2015
Llogaritë rrjedhëse	407,149	365,698
Llogaritë e kursimit	195,233	209,041
Depozita me afat	76,206	101,135
Llogaritë e tjera të klientëve	10,255	2,183
	688,843	678,057

Gjendja e detyrimeve ndaj klientëve (llogaritë rrjedhëse, kursimet dhe depozitat me afat) përfshijnë shumën prej 5,365 mijë eurosh (2015: 5,925 mijë euro) që paraqet kolateralin e parave të siguruar

për kredi, garanci, letër kredi dhe urdhërpagesa në emër të klientëve.

Normat e interesit vjetor të publikuara, më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 ishin si më poshtë:

	2016	2015
Llogaritë e kursimit	0.05%	0.05%
Depozitat me afat:		
-Gjashtë muaj	n/a	n/a
-Një vit	0.10%	0.05%
-Dy vjet	0.10%	0.10%
-Tre vjet	0.10%	0.50%
-Katër vjet	0.10%	1.00%
-Pesë vjet	0.50%	1.50%

Llogaritë rrjedhëse zakonisht nuk bartin interes.

21. Huazimet dhe borxhi i varur

	2016	2015
Fondet e huazuara nga Banka Evropiane e Investimeve (EIB)	10,034	8,021
Borxhi i varur nga "ProCredit Holding AG & CO.KGaA"	7,645	7,647
	17,679	15,668

Duke u bazuar në një marrëveshje me EIB-në, të nënshkruar në nëntor të 2013-s, banka mori kështin e fundit prej 2,000 mijë eurosh gjatë vitit 2016. Sipas marrëveshjes, qëllimi i këtyre mjeteve është financimi i projekteve të ndërmarra nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Këto mjete janë me afat maturimi deri në 7 vjet.

Borxhi i varur prej 7,500 mijë eurosh (2015: EUR 7,500 mijë) ishte siguruar nga "ProCredit Holding

AG & Co. KGaA" sipas një marrëveshjeje për kredi të varur, të nënshkruar në shtator të vitit 2014. Borxhi i varur prej 7,645 mijë eurosh (2015: 7,647 mijë EUR), më 31 dhjetor 2016, përfshin kryegjënë dhe interesat akruale.

Në bazë të miratimit të dhënë nga Banka Qendrore e Kosovës, detyrimet e varura janë klasifikuar si kapital i nivelit të dytë dhe përfshihen në kapitalin rregullator të bankës.

22. Detyrimet tjera financiare

	2016	2015
Shpenzimet akruale	84	133
Të pagueshmet ndaj furnizuesve	1,056	880
Detyrimet ndaj palëve të lidhura	167	159
Kontributi pensional i pagueshëm ndaj Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës	78	95
	1,385	1,267

23. Detyrimet tjera

	2016	2015
Provizioni për lejet e pashfrytëzuar	171	207
Provizioni për rastet gjyqësore	912	706
Provizioni për garancitë	260	278
Të tjera	516	925
	1,859	2,116

24. Kapitali aksionar dhe rezervat Kapitali aksionar

Më 31 dhjetor 2016 kapitali aksionar i autorizuar

përbëhej nga 12,269,242 aksione të zakonshme (2015: 12,269,242), me vlerë nominale prej 5 eurosh secili, ndërsa struktura e zotërimit ishte si më poshtë:

	Numri i aksioneve	Në EUR	%
"ProCredit Holding"	12,269,242	61,346,210	100
	12,269,242	61,346,210	100

Aksionet e emetuara janë plotësisht të paguara. Nuk ka kufizime, kushte ose preferenca të bashkëngjitura aksioneve të zakonshme.

Primi i aksioneve

Primi i aksioneve prej 4,204 mijë eurosh (2015: 4,204 mijë EUR) paraqet tepricën e kontributit të pranuar mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara.

Rezerva kushtëzuese

Rezerva kushtëzuese prej 511 mijë eurosh ishte krijuar në vitin 2000, përmes kapitalizimit të fitimeve të mbajtura. Rezerva paraqet një provizion kundrejt rrezikut politik dhe nuk mund të shpërndalet në dividendë pa miratimin paraprak të BQK-së.

	2016	2015
Gjendja më 1 janar	(6)	(64)
Rënie të vlerës rezervë për investimet VPS	(602)	(1,993)
Rritje të vlerës rezervë për investimet VPS	856	2,057
Tatimet e shtyra për rivlerësimin e rezervës për investimet VPS	(25)	(6)
Gjendja më 31 dhjetor	223	(6)

Dividendët e paguar

Në maj është miratuar dividendi në shumën prej 20,000 mijë eurosh në total ose 1.63 euro për aksion (2015: 20,000 mijë EUR ose 1.63 EUR për aksion) dhe i është paguar aksionarit të vetëm në qershor të vitit 2016.

25. Transaksionet me palët e lidhura

Grupi "ProCredit" përbëhet nga banka të orientuara drejt zhvillimit që operojnë në Evropën Lindore dhe në Amerikën Latine, si dhe një bankë në Gjermani. Kompania ëmë e grupit është "ProCredit

Rezerva e vlerës së drejtë

Rezerva e vlerës së drejtë përfshin ndryshimin kumulativ neto në vlerën e drejtë të investimeve të vlefshme për shitje deri në momentin kur investimi çregjistrohet ose zhvlerësohet.

24. Kapitali aksionar dhe rezervat (vazhdim)

Lëvizjet në rezervën e vlerës së drejtë paraqiten më poshtë:

Holding", një subjekt me seli në Frankfurt, i cili e udhëheq grupin. Grupi nuk ka një subjekt kontrollues përfundimtar. Në nivelin e përbashkët grupi mbikëqyrret nga autoritetet federale gjermane të mbikëqyrjes bankare ("BaFin" dhe "Bundesbank"). Grupi "ProCredit" synon të kombinojë ndikimin e lartë zhvillimor me sukses tregëtues për aksionarët e tij.

Në vazhden e zhvillimit të biznesit të saj me natyrë bankare, banka ka hyrë në transaksione të ndryshme biznesi me palë të lidhura dhe me aksionerin dhe subjektet e lidhura, më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë si më poshtë:

	Marrëdhënia	2016	2015
Aktive të arkëtueshme nga:			
Kredi dhe paradhënie për banka të tjera "ProCredit"	Subjekte nën kontroll të	4,472	5,664
Aktive financiare nga banka të tjera "ProCredit"	përbashkët	89	73
Aktive financiare nga "Quiipu GmbH"		39	59
Aktive të tjera financiare		17	48
		4,617	5,844
Detyrime ndaj:			
Detyrime ndaj bankave të tjera "ProCredit"		391	194
Detyrime financiare ndaj bankave të tjera "ProCredit"	Subjekte nën kontroll të	133	159
Detyrime financiare ndaj "Quiipu GmbH"	përbashkët	33	-
Detyrime ndaj "Quiipu GmbH"		97	306
Detyrime ndaj "ProCredit Holding AG & Co. KGaA"		99	124
Borxhi i varur nga "ProCredit Holding AG & Co. KGaA"	Kompania mëmë	7,645	7,647
		8,398	8,430

25. Transaksionet me palët e lidhura (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2016, banka kishte një marrëveshje për linjë kredie me “ProCredit Holding” me një limit të patërhequr deri në shumën prej 15,000 mijë eu-

rosh (2015: 15,000 mijë EUR), që maturohet më 11 mars 2017 (data e maturimit shtyhet automatikisht me një vit), dhënë me qëllim të përmbushjes së nevojave të përgjithshme financiare.

	Marrëdhënia	2016	2015
Të ardhura nga interesi:			
Të ardhura nga interesi nga bankat “ProCredit”	Nën kontroll	(7)	3
Të ardhura të tjera nga grupi “ProCredit”	të përbashkët	1	3
		(6)	6
Shpenzime:			
Kompania mëmë: Shpenzimet e interesit për borxhin e varur	Kompani mëmë	517	538
Kompania mëmë: Shpenzimet tjera administrative	Kompani mëmë	1,217	1,007
Kompania mëmë dhe akademitë: Shpenzimet e trajnimit	Kompani mëmë	575	541
Kompania mëmë: Tarifatat e angazhimit	Kompani mëmë	128	152
“Quipu GmbH”: Shërbime të TI-së	Nën kontroll	1,339	955
“Quipu GmbH”: Tarifatat e përpunimit të kartelave	të përbashkët	1,271	1,250
		5,047	4,443

Kompensimi i menaxhmentit të lartë:	2016	2015
Pagat	263	246
Kontribute pensionale afatshkurtra (skema e detyrueshme)	13	12
Tatimet në të ardhurat personale	24	22
	300	280

26. Zotimet dhe kontigjencat

	2016	2015
Zotimet për ofrimin e garancive, letër kredive dhe kredive		
Zotimet kreditore (shih detajet më poshtë)	61,281	55,946
Garancitë ndërkombëtare	16,840	15,282
Garancitë vendore	9,712	12,812
Letër kreditë	536	1,551
Minus: Provizionet e njohura si detyrime	(260)	(278)
	88,109	85,313
Zotimet kreditore		
Kartelat e kredive të pashfrytëzuara	3,909	4,190
Limitet e pashfrytëzuara të mbitërheqjes	38,818	43,715
Transhet e kredive të padisbursuara	9,732	2,613
Pjesa e pashfrytëzuar e linjave kreditore	8,822	5,428
	61,281	55,946

Garancionet dhe letra e kredive të dhëna në favor të klientëve sigurohen nga kolaterale mjetesh monetare, pasuri të paluajtshme ose garanci të marra nga institucionet e tjera financiare.

Zotimet për ofrimin e kredive paraqesin zotimet kontraktuale për të dhënë kredi dhe kredi të cilat nuk kanë pagesa fikse si për shembull kartat e kreditit. Zotimet në përgjithësi kanë data fikse të skadimit ose kushte të tjera të përfundimit. Meqë angazhimet mund të skadojnë pa qenë të tërhequra, shumat totale nuk paraqesin medemos kërkesat e parasë së gatshme.

Rastet gjyqësore

Në vazhdim të punës së zakonshme banka ballafaqohet me kërkesa ligjore dhe me raste gjyqësore. Menaxhimi i bankës beson se rezultati final i këtyre çështjeve ligjore, të hapura deri më 31 dhjetor 2016, nuk do të rezultojë në humbje materiale, përveç atyre të theksuara tashmë (Shënimi 23).

26. Zotimet dhe kontigjencat (vazhdim)

Zotimet e qirave operative

Banka ka lidhur kontrata operative të qirasë për ambiente të zyrave të saj. Më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 pagesat e ardhshme të qirave operative të paanulueshme për bankën ishin 231 mijë euro (2015: 244 mijë EUR). Shumica e këtyre zotimeve nuk zgjasin më shumë se një muaj.

27. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese

Nuk ka ndodhur asnjë ngjarje materiale pas datës së raportimit që do të kërkonte shpalosje në pasqyrat financiare.





